



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare
www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.40

2006

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Ligj nr.9504 datë 3.4.2006	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Kombeve të Bashkuara “Për transportin e mallrave me rrugë detare (Rregullat e Hamburgut)”..... 1235
Ligj nr.9505 datë 3.4.2006	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit Ministror të Konfederatës Zvicerane për bashkëpunimin policor në luftën kundër krimit”..... 1249
Ligj nr.9510 datë 10.4.2006	Për ratifikimin e “Marrëveshjes financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Artigiancassa S.P.A. për financimin e programit “Periferitë urbane të Tiranës–komponenti infrastrukturor””..... 1257
Vendim i Kuvendit nr.24, datë 3.4.2006	Për caktimin e anëtarëve zëvendësues në Komisionet e Përhershme të Kuvendit..... 1265
Vendim i Kuvendit nr.26, datë 20.4.2006	Për caktimin e anëtarëve zëvendësues në Komisionet e Përhershme të Kuvendit..... 1266

L I G J
Nr.9504, datë 3.4.2006

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN E KOMBEVE TË
BASHKUARA “PËR TRANSPORTIN E MALLRAVE ME RRUGË DETARE (RREGULLAT E
HAMBURGUT)”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Konventën e Kombeve të Bashkuara “Për transportin e mallrave me rrugë detare (Rregullat e Hamburgut)”, bërë në Hamburg më 31 mars 1978.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4838, datë 25.4.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

KONVENTA E KOMBEVE TË BASHKUARA
PËR TRANSPORTIN E MALLRAVE ME RRUGË DETARE

(RREGULLAT E HAMBURGUT)
(HAMBURG, MË 31 MARS TË VITIT 1978)

Shtetet Palë në këtë Konventë,
duke pranuar vullnetin për të vendosur me anë të marrëveshjes disa rregulla në lidhje me
transportin e mallrave në rrugë detare,
kanë vendosur të lidhin një marrëveshje për këtë qëllim dhe kanë rënë dakord si më poshtë vijon:

SEKSIONI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Termat

Në këtë Konventë:

1. Termi “Transportues mallrash” nënkupton çdo person nga i cili ose në emër të të cilit është lidhur një kontratë për transportin e mallrave me rrugë detare me një dërgues të mallit.
2. Termi “Transportues aktual” nënkupton çdo person të cilit i është besuar transporti i mallrave ose një pjesë e ngarkesës nga transportuesi dhe përfshin çdo person tjetër të cilit i është besuar kjo detyrë.
3. Termi “Dërgues malli” nënkupton çdo person nga i cili ose në emër të të cilit lidhet një kontratë transporti mallrash me rrugë detare me një transportues ose çdo person nga i cili ose në emër të të cilit dorëzohen mallrat te transportuesi në raport me kontratën e transportit në rrugë detare.
4. Termi “Marrës në dorëzim i mallrave” nënkupton personin e autorizuar të marrë në dorëzim mallrat.
5. “Mallra” përfshin gjënë e gjallë; kur mallrat konsolidohen në kontenier, paletë ose artikuj të ngjashëm transporti, apo kur ato paketohen, “mallrat” përfshijnë artikuj të tillë transporti ose koli të paketuara, nëse furnizohen nga dërguesi i mallit.
6. Kontrata e transportit detar nënkupton çdo kontratë, në përputhje me të cilën transportuesi përkundrejt pagesës së ngarkesës ndërmerr transportimin e mallrave në rrugë detare nga një port te tjetri; megjithatë, një kontratë e cila përfshin transportin detar dhe gjithashtu transportin me mjete të tjera, konsiderohet të jetë një kontratë transporti me rrugë detare për qëllime të kësaj Konvente, vetëm nëse ka

lidhje me transportin detar.

7. Termi “Fletëngarkesë” nënkupton një dokument, i cili provon një kontratë transporti me rrugë detare dhe marrjen e ngarkesës së mallrave nga transportuesi dhe nga e cila transportuesi ndërmerr të dorëzojë mallrat përkundrejt dorëzimit të dokumentit. Një klauzolë në dokument që mallrat duhet të dorëzohen me urdhër të një personi të autorizuar ose të një bartësi.

8. “Me shkrim”, mes të tjerash, përfshin korrespondencën me telegram dhe teleks.

Neni 2

Fusha e zbatimit

1. Dispozitat e kësaj Konvente janë të zbatueshme për të gjitha kontratat e transportit me rrugë detare midis dy shteteve të ndryshme, nëse:

a) porti i ngarkimit, siç parashikohet në kontratën e transportit me rrugë detare, ndodhet në një Shtet Palë Kontraktues, ose

b) porti i shkarkimit, siç parashikohet në kontratën e transportit me rrugë detare, ndodhet në një Shtet Kontraktues, ose

c) një nga portet fakultative të shkarkimit, të parashikuara në kontratën e transportit me rrugë detare, është porti aktual i shkarkimit dhe ky port ndodhet në një Shtet Kontraktues, ose

d) fletëngarkesa apo ndonjë dokument tjetër që provon kontratën e transportit detar lëshohet në një Shtet Palë Kontraktues, ose

e) fletëngarkesa apo dokumente të tjera që provojnë kontratën e transportit me rrugë detare sigurojnë që dispozitat e kësaj Konvente ose legjislacioni i ndonjë shteti palë që u jep atyre fuqi ligjore përcaktohen nga kontrata.

2. Dispozitat e kësaj Konvente zbatohen pa marrë në konsideratë kombësinë e anijes, transportuesin, transportuesin aktual, dërguesin e mallit, marrësin në ngarkim të mallit ose ndonjë person tjetër të interesuar.

3. Dispozitat e kësaj Konvente nuk zbatohen për kontratat e transportit. Megjithatë, kur lëshohet një fletëngarkesë sipas një kontrate transporti, dispozitat e Konventës zbatohen për këtë fletëngarkesë, nëse rregullohet marrëdhënia midis transportuesit dhe mbajtësit të fletëngarkesës, duke mos qenë palë në kontratën e transportit.

4. Nëse një kontratë parashikon transportin e mëtejshëm të mallrave në një sërë ngarkesash gjatë një periudhe të rënë dakord, dispozitat e kësaj Konvente zbatohen për çdo ngarkesë malli. Megjithatë, kur bëhet një ngarkesë mallrash sipas një kontrate transporti, zbatohen dispozitat e paragrafit 3 të këtij neni.

Neni 3

Interpretimi i konventës

Në interpretimin dhe zbatimin e dispozitave të kësaj Konvente, do t’i kushtohet vëmendje karakterit të saj ndërkombëtar dhe nevojës për nxitjen e uniformitetit.

SEKSIONI II

PERGJEGJËSIA E TRANSPORTUESIT

Neni 4

Periudha e përgjegjësisë

1. Përgjegjësia e transportuesit për mallrat sipas kësaj Konvente mbulon periudhën gjatë së cilës transportuesi merr në ngarkim mallrat në portin e ngarkimit, gjatë transportit dhe në portin e shkarkimit.

2. Për qëllim të paragrafit 1 të këtij neni, transportuesi konsiderohet që i ka mallrat në ngarkim të tij.

a) Prej kohës që ka marrë mallrat në dorëzim nga:

i) dërguesi i mallit ose një person që vepron në emër të tij; ose

ii) një autoritet apo një palë tjetër e tretë të cilës, sipas ligjit ose rregulloreve të zbatueshme në portin e ngarkimit, duhet t’i dorëzohen mallrat për ngarkesë;

b) deri në kohën që ai i ka livruar mallrat:

i) duke i dorëzuar mallrat marrësit në ngarkim të mallit; ose

ii) në rastet kur marrësi në ngarkim i mallit nuk i merr mallrat nga transportuesi, duke i vënë ato në

dispozicion të marrësit në ngarkim të mallit në përputhje me kontratën ose me ligjin apo me përdorimin e tregtisë specifike, të zbatueshme në portin e shkarkimit; ose

iii) duke i dorëzuar mallrat një autoriteti ose një pale tjetër të tretë, të cilave u dorëzohen mallrat, sipas ligjit ose rregulloreve të zbatueshme në portin e shkarkimit.

3. Në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, referenca ndaj transportuesit ose marrësit në ngarkim të mallit nënkupton, përveç transportuesit ose marrësit në ngarkim të mallit, punonjësit ose agjentët, përkatësisht të transportuesit ose marrësi në ngarkim të mallit.

Neni 5

Baza e përgjegjësisë

1. Transportuesi ka përgjegjësi për humbjen që rezulton nga humbja ose dëmi ndaj mallrave, si dhe nga vonesa në dërgimin e tyre, nëse ngjarja që shkaktoi humbjen, dëmin ose vonesën ka ndodhur ndërsa mallrat ishin në ngarkim të tij siç përcaktohet në nenin 4, përveçse kur transportuesi provon që ai, punonjësit ose agjentët e tij kanë marrë të gjitha masat që mund të kërkoreshin në mënyrë të arsyeshme, për të shmangur këtë ngjarje dhe pasojat e saj.

2. Vonesa në dërgim ndodh kur mallrat që nuk janë dërguar në portin e shkarkimit, të parashikuara në kontratën e transportit me rrugë detare brenda kohës së rënë shprehimisht dakord ose në mungesë të kësaj Marrëveshjeje, brenda kohës që do të ishte e arsyeshme për të kërkuar një transportues të kujdesshëm, duke marrë në konsideratë rrethanat e çështjes.

3. Personi i autorizuar për të kërkuar zhdëmtim për humbjen e mallrave mund t'i trajtojë mallrat si të humbura, nëse ato nuk janë dorëzuar, siç kërkohej nga neni 4, brenda 60 ditëve rresht pas mbarimit të kohës për dorëzim, sipas paragrafit 2 të këtij neni.

4. a) Transportuesi ka përgjegjësinë:

i) për humbjen ose dëmin ndaj mallrave apo vonesën në dërgim shkaktuar nga zjarri, nëse paditësi provon që zjarri është shkaktuar nga faji ose pakujdesia e transportuesit, punonjësve ose agjentëve të tij;

ii) për këtë humbje, dëm ose vonesë në dërgim, të cilat provohen nga paditësi të kenë rezultuar nga faji ose pakujdesia e transportuesit, punonjësve ose agjentëve të tij, në marrjen e të gjitha masave që mund të kërkoreshin në mënyrë të arsyeshme për të fikur zjarrin dhe për të shmangur ose lehtësuar pasojat e tij.

b) Në rast zjarri në bordin e një anijeje që prek mallrat, nëse paditësi ose transportuesi dëshiron, duhet të bëhet një vëzhgim në përputhje me praktikën e transportit, në lidhje me shkakun dhe rrethanat e zjarrit dhe një kopje e raportit të kontrollorit, do të bëhet me kërkesë të transportuesit dhe të paditësit.

5. Për sa i përket gjësë së gjallë, transportuesi nuk është përgjegjës për humbjen, dëmtimin ose vonesën në dërgimin që rezulton nga ndonjë rrezik specifik, që lidhet me faktorë të karakterit të brendshëm për këtë tip ngarkese transporti. Kur transportuesi provon që ai ka respektuar me përpikëri instruksionet e veçanta që i janë dhënë nga dërguesi i mallit për respektimin e kujdesit ndaj kafshëve dhe që, në rrethanat e çështjes, humbja, dëmtimi ose vonesa në dërgim janë shkaktuar nga këto rreziqe specifike, përveçse në rastet kur ka prova që e gjitha ose një pjesë e humbjes, dëmtimit ose vonesës në dërgim ka rezultuar nga faji ose pakujdesia e transportuesit, punonjësve ose agjentëve të tij.

6. Transportuesi nuk është përgjegjës, përveçse në mesataren e përgjithshme, ku humbja, dëmi ose vonesa në dërgim ka rezultuar si pasojë e masave për shpëtimin e jetës ose nga masat e arsyeshme për të shpëtuar pronësinë në det.

7. Kur faji ose pakujdesia nga ana e transportuesit, punonjësve ose agjentëve të tij kombinohet me një shkak tjetër që gjeneron humbje, dëmtim ose vonesë në dërgim, transportuesi është përgjegjës vetëm në shkallën që humbja, dëmtimi ose vonesa në dërgim i atribuohet këtij faji ose pakujdesie, me kusht që transportuesi të provojë sasinë e humbjes, dëmtimit ose vonesës në dërgim që nuk i atribuohet atij.

Neni 6

Kufijtë e përgjegjësisë

1. a) Përgjegjësia e transportuesit për humbjen e rezultuar nga humbja ose dëmi ndaj mallrave, sipas dispozitave të nenit 5, kufizohet në sasinë ekuivalente të 835 njësi llogaritëse për koli, ose njësi tjetër transporti të ngarkesës, ose 2.5 njësi llogaritëse për kilogram të peshës bruto të mallrave të humbura ose të dëmtuara, duke marrë prej tyre atë shifër që rezulton më e lartë.

b) Përgjegjësia e transportuesit në lidhje me vonesën në dërgim, sipas dispozitave të nenit 5, kufizohet në sasinë ekuivalente me dy herë e gjysmë të ngarkesës së pagueshme për mallrat e vonuara, por pa tejkaluar ngarkesën totale të pagueshme, sipas kontratës së transportit të mallrave me rrugë detare.

c) Përgjegjësia kolektive e transportuesit, sipas të dy nënparagrafëve a dhe b të këtij paragrafi, nuk duhet të tejkalojë në asnjë rast kufizimin që duhet të krijohet sipas nënparagrafit (a) të këtij paragrafi për humbjen totale të mallrave, në lidhje me të cilën ka ndodhur kjo përgjegjësi.

2. Për qëllim të llogaritjes se cila sasi është më e lartë në përputhje me paragrafin 1 a të këtij neni, zbatohen rregullat e mëposhtme:

a) kur një kontenier, paletë ose artikull i ngjashëm transporti përdoret për të konsoliduar mallrat, paketimi ose njësi të tjera ngarkese të renditura në fletëngarkesën që mund të jetë lëshuar, ose në ndonjë dokument tjetër që provon kontratën e transportit me rrugë detare, siç paketohen në këtë artikull transporti, atëherë këto cilësohen si koli ose njësi ngarkese. Përveç se në rastet si më sipër, mallrat në këtë artikull të transportit cilësohen si një njësi ngarkese.

b) Në rastet kur artikulli i transportit ka humbur ose është dëmtuar, ky artikull transporti, nëse nuk zotërohet ose furnizohet nga transportuesi, konsiderohet një njësi e veçantë ngarkese.

3. Njësia e llogarisë nënkupton njësinë llogaritëse të përmendur në nenin 26.

4. Me marrëveshje midis transportuesit dhe dërguesit, mund të përcaktohen kufijtë e përgjegjësisë që tejkalojnë ato të parashikuara në paragrafin 1.

Neni 7

Aplikimi për dëmshpërblime jokontraktuale

1. Mbrojtjet dhe kufijtë e përgjegjësisë të parashikuara në këtë Konventë zbatohen në çdo padi kundër transportuesit në lidhje me humbjen ose dëmin ndaj mallrave në ngarkim sipas kontratës së transportit me rrugë detare, si dhe nga vonesa në dorëzim qoftë kur padia bazohet në kontratë, kur nuk është e bazuar, apo ndonjë formë tjetër.

2. Nëse kjo padi bëhet kundër një punonjësi ose agjenti të transportuesit, si shërbyes ose agjent, dhe nëse ai provon se ka vepruar brenda fushës së punësimit të tij, ai është i autorizuar të shfrytëzojë mbrojtjet dhe kufijtë e përgjegjësisë, të cilat transportuesi është i autorizuar të respektojë sipas kësaj Konvente.

3. Përveç rastit që parashikohet në nenin 8, shuma totale e sasive të rikuperueshme nga transportuesi dhe nga personat e referuar në paragrafin 2 të këtij neni, nuk duhet të tejkalojë kufijtë e përgjegjësisë të parashikuara në këtë Konventë.

Neni 8

Humbja e së drejtës për kufizimin e përgjegjësisë

1. Transportuesi nuk është i autorizuar të përfitojë nga kufizimi i përgjegjësisë, parashikuar në nenin 6, nëse nuk provohet se humbja, dëmtimi apo vonesa në dërgim ka rezultuar nga një akt ose përjashtim i transportuesit, bërë me qëllim shkaktimin e kësaj humbjeje, dëmtimi ose vonese apo pakujdesish dhe me dijeninë se mund të rezultonte kjo humbje, dëmtim ose vonesë.

2. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 2 të nenit 7, një punonjës ose agjent i transportuesit nuk është i autorizuar të përfitojë nga kufizimi i përgjegjësisë, parashikuar në nenin 6, nëse provohet se humbja, dëmtimi ose vonesa në dërgim ka rezultuar nga një akt ose përjashtim i transportuesit, bërë me qëllim shkaktimin e kësaj humbjeje, dëmtimi ose vonese apo pakujdesish dhe me dijeninë se mund të rezultonte kjo humbje, dëmtim ose vonesë.

Neni 9

Ngarkesa në kuvertën e anijes

1. Transportuesi është i autorizuar të transportojë mallrat në kuvertën e anijes vetëm nëse kjo ngarkesë është në përputhje me marrëveshjen me dërguesin, ose me përdorimin e një tregtie specifike, ose kur kërkohet nga rregullat statutores apo rregulloret.

2. Nëse transportuesi dhe dërguesi kanë rënë dakord që mallrat duhet ose mund të transportohen në kuvertën e anijes, transportuesi duhet të paraqesë në fletëngarkesë ose, në dokumentin tjetër që provon kontratën e transportit me rrugë detare, një deklaratë për këtë qëllim. Në mungesë të kësaj deklarate, transportuesi ka barrën e provës që është lidhur një marrëveshje për transport në kuvertën e anijes; megjithatë, transportuesi nuk është i autorizuar të kërkojë një marrëveshje të tillë kundër një pale të tretë, duke përfshirë edhe marrësin në dorëzim të mallit, i cili ka marrë fletëngarkesën në mirëbesim.

3. Kur mallrat janë transportuar në kuvertën e anijes kundër dispozitave të paragrafit 1 të këtij neni ose kur transportuesi, sipas paragrafit 2 të këtij neni, nuk mund të kërkojë një marrëveshje për transportin në kuvertën e anijes, transportuesi, pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1 të nenit 5, është përgjegjës për humbjen ose dëmtimin e mallrave, si dhe për vonesën në dërgim që rezulton si pasojë e transportit në kuvertën e anijes, dhe shkalla e përgjegjësisë së tij duhet të përcaktohet sipas rastit, në përputhje me dispozitat e nenit 6 ose nenit 8 të kësaj Konvente.

4. Transporti i mallrave në kuvertën e anijes, në kundërshtim me marrëveshjen e posaçme për transportin nën kuvertën e anijes, cilësohet si një akt ose përjashtim i transportuesit brenda kuptimit të nenit 8.

Neni 10

Përgjegjësia e transportuesit dhe e transportuesit aktual

1. Kur kryerja e transportit ose një pjesë e tij i është besuar transportuesit aktual, në vijim ose jo të një lejeje, bazuar në kontratën e transportit me rrugë detare për ta bërë këtë, transportuesi qëndron përgjegjës për të gjithë transportin, sipas dispozitave të kësaj Konvente. Transportuesi është përgjegjës në lidhje me transportin e kryer nga transportuesi aktual për aktet dhe përjashtimet e transportuesit aktual, të punonjësve dhe agentëve të tij që veprojnë brenda fushës së punësimit të tyre.

2. Të gjitha dispozitat e kësaj Konvente, që përcaktojnë përgjegjësinë e transportuesit, zbatohen gjithashtu në lidhje me përgjegjësinë e transportuesit aktual për transportin e kryer prej tij. Dispozitat e paragrafëve 2 dhe 3 të nenit 7 dhe të paragrafit 2 të nenit 8 zbatohen nëse merret një masë kundër një punonjësi ose agjenti të transportuesit aktual.

3. Çdo marrëveshje specifike, sipas së cilës transportuesi ndërmerr detyrime të paparashikuara në këtë Konventë ose heq dorë nga të drejtat e akorduara nga kjo Konventë, i shtrin efektet e saj edhe mbi transportuesin aktual vetëm nëse miratohet shprehimisht me shkrim edhe nga ai. Megjithatë transportuesi aktual mund të bjerë ose jo dakord, transportuesi mbetet gjithsesi me përgjegjësi dhe i paimunizuar nga detyrimet që rezultojnë nga kjo Marrëveshje specifike.

4. Në të gjitha rastet dhe masën kur transportuesi dhe transportuesi aktual janë përgjegjës, përgjegjësia e tyre është e përbashkët dhe individuale.

5. Shuma totale e sasive të rikuperueshme nga transportuesi, transportuesi aktual, punonjësit dhe agentët e tyre, nuk duhet të tejkalojnë kufijtë e përgjegjësisë së parashikuar në këtë Konventë.

6. Asgjë në këtë nen nuk do të paragjykojë ndonjë të drejtë rekursi midis transportuesit dhe transportuesit aktual.

Neni 11

Nëpërmjet transportit

1. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1 të nenit 10, ku një kontratë e transportit me rrugë detare parashikon qartë se një seksion i specifikuar i transportit, mbuluar nga kontrata e mësipërme, duhet të kryhet nga një person i autorizuar që nuk është transportuesi, kontrata mund të parashikojë gjithashtu që transportuesi nuk është përgjegjës për humbjen, dëmtimin ose vonesën në dërgim, shkaktuar nga një incident që ka ndodhur, ndërsa mallrat janë në ngarkim të transportuesit aktual gjatë këtij seksioni të transportit. Megjithatë, çdo specifikim që kufizon ose përjashton këtë përgjegjësi nuk ka efekt, nëse nuk fillohen procedime gjyqësore kundër transportuesit aktual, në një gjykatë kompetente sipas paragrafit 1 ose 2 të nenit 21. Barra e provës që çdo humbje, dëmtim ose vonesë në dërgim është shkaktuar nga ky incident, qëndron mbi transportuesin.

2. Transportuesi aktual është përgjegjës në përputhje me dispozitat e paragrafit 2 të nenit 10 për humbjen, dëmtimin ose vonesën në dërgim të shkaktuar nga një incident që ndodh ndërsa mallrat janë në ngarkim të tij.

SEKSIONI III PËRGJEGJËSIA E DËRGUESIT

Neni 12

Rregulla të përgjithshme

Dërguesi i mallit nuk është përgjegjës për humbjen e pësuar nga transportuesi ose transportuesi

aktual apo për dëmin e pësuar nga anija, përveçse kur kjo humbje ose dëmtim është shkaktuar nga vetë faji ose pakujdesia e dërguesit, e punonjësve ose e agjentëve të tij. Si punonjësit, as agjentët e dërguesit të mallit nuk janë përgjegjës për këtë humbje ose dëmtim, përveçse kur humbja ose dëmtimi është shkaktuar nga faji ose pakujdesia e tyre.

Neni 13

Rregulla specifike mbi mallrat e rrezikshme

1. Dërguesi duhet të markerojë ose etiketojë në mënyrë të përshtatshme mallrat e cilësuar si të rrezikshme.

2. Kur dërguesi dorëzon mallrat e rrezikshme për transportuesin ose transportuesin aktual, sipas rastit, dërguesi duhet ta informojë atë për karakterin e rrezikshëm të mallrave dhe, nëse është e nevojshme, për masat që duhen marrë. Nëse dërguesi nuk arrin ta bëjë këtë dhe kur ky transportues ose transportues aktual nuk ka dijeni për karakterin e tyre të rrezikshëm, atëherë:

a) dërguesi është përgjegjës ndaj transportuesit dhe transportuesit aktual për humbjen e rezultuar nga ngarkesa e këtyre mallrave, dhe

b) mallrat, në çdo kohë, mund të shkarkohen, shkatërrohen ose të bëhen të padëmshme, sipas kushteve e rrethanave, pa asnjë pagesë kompensimi.

3. Dispozitat e paragrafit 2 të këtij neni nuk mund të kërkojnë nga ndonjë person nëse gjatë transportit ai ka marrë mallrat në ngarkim, duke qenë në dijeni të karakterit të tyre të rrezikshëm.

4. Në rastet kur dispozitat e paragrafit 2 nënparagrafi (b) i këtij neni nuk zbatohen ose nuk mund të invokohen, mallrat e rrezikshme bëhen një rrezik i prekshëm për jetën ose pasurinë, si pasojë ato mund të shkarkohen, shkatërrohen ose të bëhen të padëmshme, sipas rrethanave, pa pagesë kompensimi, përveçse kur ka një detyrim për të kontribuar në mesataren e përgjithshme ose kur transportuesi është përgjegjës, në përputhje me dispozitat e nenit 5.

SEKSIONI IV

DOKUMENTET E TRANSPORTIT

Neni 14

Lëshimi i fletëngarkesës

1. Kur transportuesi ose transportuesi aktual merr mallrat në ngarkim, transportuesi duhet t'i lëshojë dërguesit një fletëngarkesë, me kërkesë të dërguesit.

2. Fletëngarkesa mund të nënshkruhet nga një person që ka autoritetin e transportuesit. Një fletëngarkesë e nënshkruar nga kapiteni i anijes që transporton ngarkesën e mallrave nënkupton se është nënshkruar në emër të transportuesit.

3. Nënshkrimi i fletëngarkesës mund të bëhet i nënshkruar me dorë, i printuar në faksimile, i biruar, i stampuar me vulë, me simbole, apo i bërë nga çdo mjet tjetër elektronik apo mekanik, nëse nuk është në kundërshtim me ligjet e vendit për ku është lëshuar fletëngarkesa.

Neni 15

Përmbajtja e fletëngarkesës

1. Fletëngarkesa duhet të përmbajë, midis të tjerash, të dhënat specifike të mëposhtme:

a) natyrën e përgjithshme të mallrave, markerimin orientues të nevojshëm për identifikimin e mallrave, një deklaram shprehës, nëse është e aplikueshme, për sa i përket karakterit të rrezikshëm të mallrave, numrin e kolive ose të copëve, peshën e mallrave apo shprehur ndryshe, sasinë e tyre, të gjitha këto të dhëna specifike, ashtu siç janë emërtuar nga ana e dërguesit të mallit;

b) gjendjen e mallrave sipas pamjes së tyre;

c) emrin dhe vendin kryesor të kryerjes së biznesit të agjencisë së transportit;

d) emrin e dërguesit të mallit;

e) emrin e dorëzuesit të mallit nëse përmendet nga dërguesi i mallit;

f) portin e ngarkimit sipas kontratës së transportit në rrugë detare dhe datën në të cilën mallrat janë marrë në ngarkim nga transportuesi (agjencia e transportit) në portin e ngarkimit;

g) portin e shkarkimit sipas kontratës së transportit me anë të detit;

h) numrat e origjinaleve të fletëngarkesave, nëse janë më shumë se një;
 i) vendi i lëshimit të fletëngarkesës;
 j) nënshkrimin e transportuesit apo të një personi tjetër të ngarkuar nga ai;
 k) pagesën e transportit në masën e pagueshme nga ana e marrësit në dorëzim të ngarkesës ose të dhëna të tjera që ngarkesa është e pagueshme nga ana e tij;
 l) deklarin që referohet sipas paragrafit 3 të nenit 23;
 m) deklarin, nëse është i aplikueshëm, që mallrat duhet apo mund të mbahen mbi kuvertë;
 n) datën ose periudhën e dorëzimit të mallrave në portin e shkarkimit, nëse për këtë është rënë dakord në mënyrë të qartë midis palëve; dhe
 o) rritjen e kufizimeve të detyrimeve apo përgjegjësive kur është rënë dakord në përputhje me paragrafin 4 të nenit 6.

2. Pasi mallrat janë ngarkuar në anije, sipas kërkesës së dërguesit të mallit, transportuesi duhet t'i lëshojë dërguesit të mallit një fletëngarkesë "për transportin e mallit", e cila përveç të dhënave specifike të shprehura në paragrafin 1 të këtij neni, duhet të shprehë që mallrat janë ngarkuar në anijen/anijet me emrin përkatës, si dhe datën/datat përkatëse të ngarkimit. Nëse transportuesi i ka lëshuar më parë dërguesit të mallit një fletëngarkesë apo dokument tjetër me mallra që i përkasin së njëjtës ngarkesë, me kërkesë të transportuesit, dërguesi i mallit duhet të dorëzojë këtë dokument në këmbim të një fletëngarkese "të transportit të mallit". Transportuesi mund të amendojë një dokument të mundshëm të lëshuar më parë në mënyrë që të plotësojë kërkesën e dërguesit të mallit për lëshimin e një fletëngarkese të rregullt "të transportit të mallit", dokument i cili pas amendamentit, përmban të gjithë informacionin që kërkohet në një fletëngarkesë të "transportit të mallit".

3. Mungesa në fletëngarkesën e një ose më shumë të dhënave specifike të shprehura në këtë nen, nuk ndikon në karakterin ligjor të këtij dokumenti si fletëngarkesë, me kusht që ky dokument të jetë në përputhje me kërkesat e shtruara në paragrafin 7 të nenit 1.

Neni 16

Fletëngarkesa: vërejtjet (rezervat) dhe efektet e evidentimit të tyre

1. Kur fletëngarkesa përmban të dhëna specifike të natyrës së përgjithshme, të markerimit orientues, të numrin e kolive apo copëve, të peshës ose sasisë së mallrave, për të cilat transportuesi apo një person tjetër i autorizuar në emër të tij për lëshimin e fletëngarkesës kanë arsye të forta për të dyshuar që këto të dhëna nuk paraqesin saktësisht mallrat e marra në dorëzim, si dhe kur një fletëngarkesë e "transportit të mallrave" është lëshuar apo kur nuk është disponuar asnjë mjet i përshtatshëm për të verifikuar këto të dhëna specifike, atëherë transportuesi (agjencia e transportit) ose personi i autorizuar duhet të shprehë vërejtje (rezerva) në fletëngarkesë duke i pasqyruar këto mospërputhje, dyshime të evidentuara apo mungesën e mjeteve të përshtatshme për t'i verifikuar ato.

2. Kur transportuesi ose personi i autorizuar prej tij për lëshimin e fletëngarkesës nuk bën asnjë shënim në fletën e ngarkesës mbi gjendjen e dukshme të mallrave, kjo supozon faktin që ai pohon në fletëngarkesë që mallrat janë në gjendje të mirë.

3. Me përjashtim të atyre të dhënave specifike, për të cilat janë shprehur vërejtje në elemente të veçanta apo në masë të caktuar sipas paragrafit 1 të këtij neni:

a) fletëngarkesa është një provë e mjaftueshme e marrjes në dorëzim të mallrave ose, kur një fletëngarkesë "e transportit të mallit" është lëshuar, atëherë ngarkimi i mallrave, nga ana e transportuesit (agjencisë së transportit) të mallrave është bërë siç përshkruhet në fletëngarkesë; dhe

b) prova e së kundërtës nga transportuesi nuk është e pranueshme nëse fletëpagesa i është transferuar një pale të tretë, përfshi edhe një marrës në dorëzim të ngarkesës, i cili me vullnet e mirëbesim ka vepruar në përputhje me përshkrimin e mallrave në fjalë.

4. Një fletëngarkesë e cila nuk paraqet ngarkesën, ashtu siç parashikohet në paragrafin 1 nënparagrafi (h) të nenit 15, ose ndryshe nuk tregon që ngarkesa është e pagueshme nga ana e marrësit në dorëzim të ngarkesës, ose që nuk paraqet dëmshpërblimin për mosngarkesën në afat që mund të ketë ndodhur në portin e ngarkimit të pagueshëm nga marrësi në dorëzim i ngarkesës, është një provë e mjaftueshme që asnjë ngarkesë mallrash apo dëmshpërblim për mosngarkimin në afat është e pagueshme nga ky i fundit. Sidoqoftë, prova e së kundërtës nga ana e transportuesit është jo e pranueshme edhe kur fletëngarkesa i është transferuar një pale të tretë, përfshi edhe një marrës në dorëzim të ngarkesës, i cili ka vepruar me mirëbesim për sa i përket mungesës në fletëngarkesë të një fakti tregues të tillë.

Neni 17

Garancitë nga ana e dërguesit të mallit

1. Dërguesi i mallit duhet t'i garantojë transportuesit të dhëna specifike të sakta për sa i përket natyrës së përgjithshme të mallrave, markerimit të tyre, numrit, peshës dhe sasisë ashtu siç janë paraqitur prej tij për t'u shënuar në fletëngarkesë. Dërguesi i mallit duhet të zhdëmtojë transportuesin ndaj çdo humbjeje që rezulton nga mospërputhjet me këto të dhëna specifike. Dërguesi i mallit mbetet përgjegjës edhe kur fletëngarkesa është transferuar nga ana e tij. E drejta e transportuesit ndaj këtij zhdëmtimi nuk e kufizon në asnjë mënyrë përgjegjësinë e tij, që rrjedh nga kontrata e transportit, ndaj ndonjë personi tjetër përveçse ndaj dërguesit të mallit.

2. Çdo letër garancie ose marrëveshje, nëpërmjet së cilës dërguesi i mallit merr përsipër të zhdëmtojë transportuesin ndaj humbjeve që rezultojnë prej fletëngarkesës së lëshuar nga ana e transportuesit, ose nga një person i autorizuar nga ana e tij, duke mos pasur ndonjë vërejtje të shënuar për sa i përket të dhënave specifike të shënuara në fletëngarkesë nga dërguesi i mallit, ose për sa i përket gjendjes së pamjes së dukshme të mallrave, është e pavlefshme dhe e paefektshme, ashtu si dhe ndaj ndonjë pale të tretë, përfshi këtu edhe një marrës në dorëzim të ngarkesës, të cilit mund t'i jetë transferuar fletëngarkesa.

3. Një letër e tillë garancie ose marrëveshje është e vlefshme kundër dërguesit të mallit nëse transportuesi apo personi i autorizuar prej tij, duke hequr vërejtjet (rezervat) sipas paragrafit 2 të këtij neni, ka qëllim të mashtrorë një palë të tretë, përfshi këtu edhe një marrës në dorëzim të ngarkesës, i cili vepron në mirëbesim me përshkrimin e mallrave në fletëngarkesë. Në këtë rast, nëse vërejtja e hequr bën fjalë për të dhënat specifike të siguruar nga dërguesi i mallit për t'u shënuar në fletëngarkesë, atëherë transportuesi nuk ka të drejtë të zhdëmtohet nga dërguesi i mallit në mbështetje të paragrafit 1 të këtij neni.

4. Në rastin e mashtrimit me qëllim sipas referencës së paragrafit 3 të këtij neni, transportuesi është përgjegjës, pa përfitimin e kufizimit të përgjegjësisë që sigurohet nga kjo Konventë, për humbjet që mund të ndodhin nga një palë e tretë, përfshi këtu një marrës në dorëzim të ngarkesës, sepse ai ka vepruar në mirëbesim me përshkrimin e mallrave në fletëpagesë.

Neni 18

Dokumentet e tjera përveç fletëngarkesës

Kur një transportues lëshon një dokument tjetër përveçse fletëngarkesë për të evidencuar marrjen e mallrave në ngarkim, një dokument i tillë është një provë e mjaftueshme e përfundimit të kontratës së transportit në rrugë detare dhe të marrjes përsipër nga ana e transportuesit të mallrave siç përshkruhen në të.

SEKSIONI V

ANKESAT DHE PADITË

Neni 19

Njoftimi i humbjeve, dëmtimeve ose vonesave

1. Përveçse në rastet kur humbja ose dëmtimi, duke specifikuar natyrën e përgjithshme të një humbjeje apo dëmtimi të tillë, jepet me shkrim nga marrësi në dorëzim i ngarkesës për transportuesin jo më vonë se dita e punës pas ditës kur mallrat i janë dorëzuar marrësit në dorëzim, ky dorëzim i mallrave është një provë e mjaftueshme e livrimit nga ana e transportuesit, të mallrave sipas përshkrimit të gjendjes së bërë në dokumentin e transportit ose, nëse nuk është lëshuar një dokument i tillë, në gjendje të mirë.

2. Kur humbjet apo dëmtimet nuk janë të dukshme, dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni zbatohen në mënyrë përkatëse nëse njoftimi me shkrim nuk është dhënë brenda 15 ditëve rresht pas ditës kur mallrat i ishin dorëzuar marrësit në dorëzim.

3. Nëse çështja e gjendjes së mallrave në kohën kur ato i janë dorëzuar marrësit në dorëzim është bërë subjekt i një vëzhgimi ose inspektimi të përbashkët nga palët, njoftimi me shkrim nuk ka nevojë të jepet për humbjet apo dëmtimet e konstatuara gjatë vëzhgimit ose inspektimit.

4. Në rastin e humbjeve apo dëmtimeve të kohëve më të fundit apo për rastet e dyshimta, transportuesi dhe marrësi në dorëzim duhet të vënë në dispozicion të njëri-tjetrit të gjitha lehtësitat e

mundshme për inspektimin dhe evidentimin e mallrave.

5. Asnjë kompensim nuk do të paguhet për humbjet që rezultojnë si shkak i vonës së livrimit të mallrave, përveçse në rastet kur transportuesi është njoftuar me shkrim brenda 60 ditëve të njëpasnjëshme pas ditës kur mallrat i janë dorëzuar marrësit në dorëzim.

6. Nëse mallrat janë livruar nga një transportues aktual, çdo njoftim që i jepet atij në hapësirën e këtij neni do të ketë të njëjtin efekt sikur ai t'i jepej transportuesit dhe çdo njoftim që i jepet transportuesit do të ketë të njëjtin efekt sikur ai t'i ishte dhënë transportuesit aktual.

7. Përveç se në rastet kur një njoftim me shkrim për humbje apo dëmtime, i cili specifikon natyrën e përgjithshme të humbjeve apo dëmtimeve, i është dërguar dërguesit të mallit nga transportuesi ose nga transportuesi aktual jo më vonë se 90 ditë të njëpasnjëshme pas ndodhjes së një humbjeje apo dëmtimi të tillë ose pas livrimit të mallrave në përputhje me paragrafin 2 të nenit 4, ai që është më vonë, mungesa e dhënies së një njoftimi të tillë është provë e mjaftueshme që transportuesi ose transportuesi aktual nuk ka mbajtur humbje apo dëmtime për shkak të fajit apo pakujdesisë së dërguesit të mallit, të agentëve apo punëtorëve që i shërbejnë atij.

8. Për qëllim të këtij neni, një njoftim që i jepet një personi që vepron në emrin e transportuesit apo të transportuesit aktual, përfshi këtu edhe kapitenin e anijes apo oficerin që ka anijen në ngarkim, apo një person tjetër që vepron në emër të dërguesit të mallit, ka kuptimin që i është dërguar respektivisht transportuesit, transportuesit aktual ose dërguesit të mallit.

Neni 20

Kufizimi i veprimeve

1. Çdo padi që lidhet me transportin e mallrave sipas kësaj Konvente është e mbrojtur në kohë të kufizuar; ky kufizim për vënien në veprim të procedimit gjyqësor ose arbitrar shtrihet në një periudhë prej dy vjetësh.

2. Periudha e kufizimit fillon në ditën në të cilën transportuesi ka livruar mallrat ose një pjesë të tyre, ose në rastet kur mallrat nuk janë livruar, në ditën e fundit në të cilën mallrat duhet të ishin livruar.

3. Dita në të cilën fillon periudha e kufizimit nuk përfshihet në kohën e kufizimit.

4. Personi ndaj të cilit është bërë një ankesë mundet që në çdo kohë gjatë periudhës së kufizimit, të shtyjë më tej këtë periudhë duke bërë një deklaramë me shkrim ndaj ankimesit. Kjo periudhë mund të shtyhet më tej nëpërmjet një deklarate apo deklaratave të tjera.

5. Një padi për zhdëmtimin nga ana e një personi që mbahet përgjegjës mund të aktivizohet edhe mbas mbarimit të periudhës së kufizimit të parashikuar në paragrafët e mëparshëm nëse ajo aktivizohet brenda kohës së lejueshme nga ligji i shtetit përkatës ku ky procedim është vënë në veprim. Megjithatë, koha e lejuar nuk mund të jetë më pak se 90 ditë duke filluar nga dita kur personi që vuri në veprim këtë padi për zhdëmtim e ka zgjidhur ankesën ose ka shërbyer me proces në padinë kundër tij.

Neni 21

Juridiksioni

1. Në procedimet gjyqësore që lidhen me transportin e mallrave sipas kësaj Konvente, paditësi, sipas përzgjedhjes së tij, mund të iniciojë një padi në një gjykatë, në përputhje me ligjin e shtetit ku ndodhet kjo gjykatë, e cila të jetë kompetente, si dhe të jetë brenda juridiksionit të së cilës ndodhet një nga vendet e mëposhtme:

a) Vendi kryesor i biznesit të të pandehurit ose, në mungesë të tij, vendbanimi i zakonshëm i të pandehurit; ose

b) Vendi ku është bërë kontrata, me kusht që i pandehuri të ketë në këtë vend një biznes, degë apo agjenci nëpërmjet së cilës është bërë kontrata; ose

c) Porti i ngarkimit ose porti i shkarkimit; ose

d) Ndonjë vend tjetër shtesë, i përcaktuar për këtë qëllim në kontratën e transportit në rrugë detare.

2. a) Megjithë dispozitat e mëparshme të këtij neni, një padi mund të vihet në veprim në gjykatat e cilitdo port apo vend të njërit prej Shteteve të Kontraktimit në të cilat anija e transportit, ose çdo anije tjetër e së njëjtës pronësi, mund të jetë ndaluar në përputhje me ligjet në fuqi të atij Shteti Palë Kontraktues dhe të ligjit ndërkombëtar. Megjithatë, në një rast të tillë, me kërkesën e të pandehurit, paditësi duhet të lëvizë padinë, sipas dëshirës së tij, në një prej juridiksioneve që i referohen paragrafit 1 të këtij neni për përcaktimin e akuzës, por përpara kësaj lëvizjeje të padisë, i pandehuri duhet të japë garanci të mjaftueshme për të siguruar pagesën e çdo vendimi gjyqësor që mund t'i jepet në vijim paditësit në këtë padi.

b) Të gjitha pyetjet që kanë të bëjnë me mjaftueshmërinë ose, ndryshe, me sigurinë duhet të përcaktohen nga gjykata e portit ose të vendit të ndalimit (arrestimit).

3. Asnjë procedim gjyqësor lidhur me transportin e mallrave sipas kësaj Konvente nuk mund të vihet në veprim në një vend që nuk është specifikuar në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni. Dispozitat e këtij paragrafi nuk përbëjnë një pengesë për juridiksionet e Shteteve Kontraktuese për masa përgatitore ose mbrojtëse.

4. a) Kur një padi është vënë në veprim në një gjykatë kompetente sipas paragrafëve 1 ose 2 të këtij neni ose kur vendimi gjyqësor është dhënë nga një gjykatë e tillë, nuk mund të fillojë më një padi e re midis palëve për të njëjtat argumente të çështjes, përveç rastit kur vendimi gjyqësor i gjykatës në të cilën është vënë në veprim padia e parë nuk është i zbatueshëm në vendin në të cilin do të vihet në veprim procedimi i ri.

b) Për qëllim të këtij neni, institucionalizimi i masave me synim arritjen e zbatimit të një vendimi gjyqësor nuk duhet të merret në konsideratë me fillimin e një padie të re.

c) Për qëllim të këtij neni, lëvizja e një padije nga një gjykatë në një gjykatë tjetër brenda të njëjtit vend, ose në një gjykatë të një vendi tjetër, në përputhje me paragrafin 2 (a) të këtij neni, nuk duhet të konsiderohet si fillimi i një padie të re.

5. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafëve të mëparshëm, në rastet kur rezulton një ankesë e bazuar në një kontratë transporti me rrugë detare, mund të arrihet një marrëveshje midis palëve për caktimin e vendit ku paditësi mund të vërë në veprim një padi.

Neni 22 **Arbitrazhi**

1. Bazuar në dispozitat e këtij neni, palët mund të arrijnë nëpërmjet një marrëveshje me shkrim që çdo mosmarrëveshje që mund të dalë për sa i përket transportit të mallrave sipas kësaj Konvente duhet të ketë si referencë arbitrazhin.

2. Kur në një kontratë transporti përmbahet një dispozitë e veçantë ku shprehet se mosmarrëveshjet që dalin nga ajo do t'i referohen arbitrazhit dhe një fletëngarkesë e lëshuar në zbatim të kësaj kontrate transporti nuk përmban një shënim të veçantë, me kusht që kjo dispozitë të jetë e detyrueshme ndaj mbajtësit të fletëngarkesës, transportuesi nuk mund të kërkojë që kjo dispozitë është kundër një mbajtësi që ka marrë fletëngarkesën në mirëbesim.

3. Procedimet e arbitrazhit duhet, mbi bazën e gjykimit të vetë paditësit, të vihet në veprim në një nga vendet e mëposhtme:

a) Një vend në një shtet në territoret e të cilit ndodhet:

i) vendi kryesor i biznesit i të pandehurit ose, në mungesë të të cilit, vendbanimi i zakonshëm i të pandehurit; ose

ii) vendi ku është bërë kontrata, me kusht që i pandehuri të ketë atje një biznes të tij, një degë apo agjenci nëpërmjet të cilave është bërë kontrata; ose

iii) Porti i ngarkimit ose porti i shkarkimit; ose

b) Një vend i caktuar për këtë qëllim në klauzolën e arbitrazhit ose të në marrëveshje.

4. Arbitruesi ose gjyqi i arbitrazhit duhet të zbatojë rregullat e kësaj Konvente.

5. Dispozitat e paragrafëve 3 dhe 4 të këtij neni paracaktohen të jenë pjesë e çdo klauzole arbitrazhi ose marrëveshjeje, dhe çdo shprehje e kësaj klauzole apo marrëveshjeje që nuk është në përputhje me to është e pavlefshme ligjrisht.

6. Asgjë në këtë nen nuk ndikon në vlefshmërinë e një marrëveshjeje që ka të bëjë me arbitrazhin e bërë midis palëve, pasi një ankim ka dalë si rezultat i kontratës së transportit me rrugë detare.

SEKSIONI VI **DISPOZITA SHITESË**

Neni 23 **Përcaktimet kontraktuale**

1. Çdo përcaktim në një kontratë transporti me rrugë detare, në një fletëngarkesë, ose në çdo dokument tjetër që dëshmon kontratën e transportit në rrugë detare është e pavlefshme ligjrisht në atë masë që ajo nuk i heq fuqinë ligjore, direkt ose indirekt, dispozitave të kësaj Konvente. Pavlefshmëria e një përcaktimi të tillë nuk ndikon mbi vlefshmërinë e dispozitave të tjera të kontratës së transportit ose dokumentit, ku ky përcaktim përbën një pjesë të tij. Një klauzolë e cila i atribuon përfitime të sigurimit të

mallrave në favor të transportuesit, ose çdo klauzolë e një formati të ngjashëm, është e pavlefshme ligjërisht.

2. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni, një transportues mund të zgjerojë përgjegjësitë dhe detyrimet e tij bazuar në dispozitat e kësaj Konvente.

3. Kur lëshohet një fletëngarkesë ose ndonjë dokument tjetër që provon kontratën e transportit me rrugë detare, ajo duhet të përmbajë një deklaram që transporti është në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente, e cila bën të pavlefshëm çdo përcaktim që heq fuqinë ligjore që buron prej saj si në dëm të dërguesit, ashtu edhe marrësit në dorëzim të mallit.

4. Kur paditësit, në lidhje me mallrat, i ka rezultuar humbje si rezultat i një përcaktimi që është i pavlefshëm ligjërisht mbi bazën e vlerësimit të këtij neni ose si rezultat i heqjes së deklaramit të referuar në paragrafin 3 të këtij neni, transportuesi duhet të paguajë kompensim në shkallën e caktuar, me qëllim që t'i japë paditësit kompensim në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente për çdo humbje ose dëmtim të mallrave, si dhe për vonesën e mundshme në dorëzimin e tyre. Për më tepër, transportuesi duhet të paguajë kompensim edhe për shpenzimet e shkaktuara nga paditësi për qëllim të ushtrimit të së drejtës së tij, me kusht që shpenzimet e shkaktuara nga padia për shkeljen e dispozitave të mësipërme duhet të përcaktohen në përputhje me ligjin e shtetit ku kanë filluar procedimet.

Neni 24

Mesatarja e përgjithshme

1. Asgjë në këtë Konventë nuk do të parandalojë zbatimin e dispozitave në kontratën e transportit me rrugë detare ose ligjin kombëtar në lidhje me rregullimin e mesatares së përgjithshme.

2. Me përjashtim të nenit 20, dispozitat e kësaj Konvente në lidhje me përgjegjësinë e transportuesit për humbjen ose dëmtimin e mallrave gjithashtu për të përcaktuar nëse marrësi në dorëzim i mallit mund të refuzojë kontributin në mesataren e përgjithshme dhe përgjegjësinë e transportuesit për të zhdëmtuar marrësin në ngarkim të mallit në lidhje me këtë kontribut të bërë ose ndonjë shpërblim të paguar.

Neni 25

Konventat e tjera

1. Kjo Konventë nuk modifikon të drejtat ose detyrat e transportuesit, transportuesit aktual dhe punonjësve e agentëve të tyre, të parashikuara në konventat ndërkombëtare ose ligjin kombëtar në lidhje me kufizimin e përgjegjësisë së pronarëve të anijeve oqeanike.

2. Dispozitat e neneve 21 dhe 22 të kësaj Konvente nuk parandalojnë zbatimin e dispozitave të detyrueshme të ndonjë konvente tjetër shumëpalëshe në fuqi në datën e kësaj Konvente, në lidhje me çështjet që janë trajtuar në nenet e mësipërme, me kusht që konflikti të ketë lindur ekskluzivisht midis palëve që kanë vendin kryesor të biznesit në shtetet anëtare të kësaj Konvente tjetër. Megjithatë, ky paragraf nuk cenon zbatimin e paragrafit 4 të nenit 22 të kësaj Konvente.

3. Asnjë përgjegjësi nuk do të lindë sipas dispozitave të kësaj Konvente për dëmin e shkaktuar nga një incident bërthamor, nëse operatori i një instalimi bërthamor është përgjegjës për këtë dëm:

a) sipas Konventës së Parisit të 29 korrikut 1960 mbi Përgjegjësinë e Palës së Tretë në Fushën e Energjisë Bërthamore, siç është amenduar nga Protokolli Shtesë i 28 janarit 1964 ose sipas Konventës së Vjenës së datës 21 maj 1963 mbi Përgjegjësinë Civile për Dëmin Bërthamor; ose

b) në bazë të ligjit kombëtar që përcakton përgjegjësinë për këtë dëm, me kusht që ky ligj të jetë në të gjitha aspektet po aq i favorshëm për personat që mund të vuajnë dëmin sa edhe Konventat e Parisit apo Vjenës.

4. Asnjë përgjegjësi që lind sipas dispozitave të kësaj Konvente për çdo humbje ose dëm apo vonesë në dorëzimin e bagazhit për të cilin transportuesi është përgjegjës sipas çdo konvente ndërkombëtare ose ligjit kombëtar në lidhje me transportin e pasagjerëve dhe bagazhin e tyre me rrugë detare.

5. Asgjë në përmbajtje të kësaj Konvente nuk parandalon një Shtet Palë Kontraktues nga zbatimi i çdo konvente tjetër ndërkombëtare, e cila është në fuqi në datën e kësaj Konvente dhe që zbatohet detyrimisht për kontratat e transportit të mallrave kryesisht me mënyrën e transportit të një lloji tjetër nga ai

detar. Kjo dispozitë gjithashtu zbatohet për ndonjë rishikim të mëtejshëm ose amendament të kësaj konvente ndërkombëtare.

Neni 26

Njësia e llogaritjes

1. Njësia e llogarisë e referuar në nenin 6 të kësaj Konvente është e drejta speciale e tërheqjes, siç është përcaktuar nga Fondi Monetar Ndërkombëtar. Sasitë e përmendura në nenin 6 duhet të konvertohen në valutën kombëtare të një shteti, sipas vlerës së kësaj valute në datën e gjykimit ose datën e rënë dakord nga palët. Vlera e valutës kombëtare, në lidhje me të drejtën speciale të tërheqjes të një Shteti Palë Kontraktues, i cili është anëtar i Fondit Monetar Ndërkombëtar, duhet të llogaritet në përputhje me metodën e vlerësimit të zbatuar nga Fondi Monetar Ndërkombëtar që është në fuqi në datën në fjalë për operacionet dhe transaksionet e tij. Vlera e valutës kombëtare në lidhje me të drejtën speciale të tërheqjes të një Shteti Palë Kontraktues, i cili nuk është anëtar i Fondit Monetar Ndërkombëtar, duhet të llogaritet në mënyrën e caktuar nga ai shtet.

2. Megjithatë, ato shtete që nuk janë anëtare të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe ligji i të cilave nuk lejon zbatimin e dispozitave të paragrafit 1 të këtij neni, në kohën e nënshkrimit ose ratifikimit, pranimit, miratimit ose hyrjes apo edhe në një kohë të mëvonshme, mund të deklarojnë se duhen caktuar kufijtë e përgjegjësisë të parashikuara në këtë Konventë, për t'u zbatuar në territoret e tyre, si për shembull: 12,500 njësi monetare për paketë ose njësie tjetër ngarkese apo 37.5 njësi monetare për kilogram të peshës bruto të mallrave.

3. Njësia monetare e referuar në paragrafin 2 të këtij neni i korrespondon gjashtëdhjetë e pesë e gjysmë miligramëve flori me një përqindje të floririt prej nëntëqind të njëmijteve. Konvertimi i sasive të referuara në paragrafin 2 në valutën kombëtare duhet të bëhet sipas ligjit të shtetit të interesuar.

4. Llogaritja e përmendur në fjalinë e fundit të paragrafit 1 dhe konvertimi i përmendur në paragrafin 3 të këtij neni, duhet të bëhet në mënyrë që të shprehë në valutën kombëtare të Shtetit Kontraktues, sa më shumë të jetë e mundur, të njëjtën vlerë reale për shumat në nenin 6, siç është shprehur aty në njësi llogaritjeje. Shtetet Kontraktuese duhet t'i komunikojnë Depozitarit mënyrën e llogaritjes sipas paragrafit 1 të këtij neni ose rezultatin e konvertimit të përmendur në paragrafin 3 të këtij neni, sipas rastit, në kohën e nënshkrimit ose kur depozitojnë instrumentet e tyre të ratifikimit, pranimit, miratimit apo hyrjes apo kur përfitojnë nga mundësia e parashikuar në paragrafin 2 të këtij neni dhe sa herë që ka një ndryshim në mënyrën e kësaj llogaritjeje ose në rezultatin e këtij konvertimi.

SEKSIONI VII

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 27

Depozitari i Konventës

Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara është përcaktuar këtu si Depozitari i kësaj Konvente.

Neni 28

Nënshkrimi, ratifikimi, pranimi, miratimi dhe aderimi

1. Kjo Konventë është e hapur për nënshkrim për të gjitha shtetet në selinë e Kombeve të Bashkuara në Nju-Jork deri në datën 30 prill të vitit 1979.

2. Kjo Konventë i nënshtrohet ratifikimit, pranimit, ose miratimit nga shtetet palë nënshkruese.

3. Pas datës 30 prill të vitit 1979, kjo Konventë është e hapur për aderim për të gjitha Shtetet Palë të cilat nuk janë shtete nënshkruese.

4. Instrumentet e ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, i cili ushtron funksionin e Depozitarit.

Neni 29

Rezervat

Asnjë rezervë nuk mund të bëhet për këtë Konventë.

Neni 30
Hyrja në fuqi

1. Kjo Konventë do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit që pason përfundimin e një periudhe njëvjeçare duke filluar nga data e depozitimit të instrumentit të 20-të të ratifikimit, miratimit, pranimit ose aderimit.

2. Për secilin shtet që bëhet një Palë Kontraktuese pas datës së depozitimit të instrumentit të 20-të të ratifikimit, miratimit, pranimit ose aderimit, kjo Konventë do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit që pason përfundimin e një periudhe njëmuajore duke filluar nga data e depozitimit të instrumentit përkatës të ratifikimit, miratimit, pranimit ose aderimit nga ai shtet.

3. Çdo Shtet Palë Kontraktues do të zbatojë dispozitat e kësaj Konvente për kontratat e transportit detar të lidhura në ose pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Konvente për atë shtet.

Neni 31
Denoncimi i konventave të tjera

1. Me bërjen e një Shteti Palë Kontraktues në këtë Konventë, çdo Shtet Palë te Konventa Ndërkombëtare për Unifikimin e Rregullave të Caktuara në lidhje me fletëngarkesën, nënshkruar në Bruksel më 25 gusht 1924 (Konventa e vitit 1924), do të njoftojë Qeverinë e Belgjikës si Depozitar i Konventës së vitit 1924, në lidhje me denoncimin e Konventës së mësipërme, duke paraqitur një deklaratë që denoncimi do të hyjë në fuqi në datën kur kjo Konventë të ketë hyrë në fuqi në lidhje me atë shtet.

2. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, sipas paragrafit 1 të neni 30, Depozitari i kësaj Konvente do të njoftojë Qeverinë e Belgjikës si Depozitar i Konventës së vitit 1924, mbi datën e hyrjes në fuqi dhe emrat e Shteteve Palë Kontraktuese në lidhje me të cilat kjo Konventë ka hyrë në fuqi.

3. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni zbatohen përshtatshmërisht në lidhje me Shtetet Palë në Protokollin e nënshkruar më 23 shkurt 1968, për të amenduar Konventën Ndërkombëtare për Unifikimin e Rregullave të Caktuara në lidhje me fletëngarkesën, e nënshkruar në Bruksel më 25 gusht 1924.

4. Pavarësisht nga neni 2 i kësaj Konvente, për qëllime të paragrafit 1 të këtij neni, një Shtet Palë Kontraktues, nëse dëshiron, mund të shtyjë denoncimin e Konventës së vitit 1924, e amenduar nga Protokollin e vitit 1968 për një periudhë maksimale prej pesë vitesh nga hyrja në fuqi e kësaj Konvente. Më pas, ajo do të njoftojë Qeverinë e Belgjikës mbi qëllimet e saj. Gjatë kësaj periudhe të përkohshme, ajo do të zbatojë këtë Konventë për Shtetet Palë Kontraktuese dhe mund të denoncojë ndonjë tjetër.

Neni 32
Rishikimi dhe amendimi i Konventës

1. Me kërkesën e të paktën një të tretës së Palëve Kontraktuese në këtë Konventë, Depozitari do të thërrasë një konferencë të Shteteve Palë Kontraktuese për rishikimin ose amendimin e saj.

2. Instrumentet e ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, i cili ushtron funksionin e Depozitarit.

3. Instrumentet e ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit që do të depozitohen pas hyrjes në fuqi të një amendamenti në këtë Konventë do të konsiderohen se i referohen Konventës së amenduar.

Neni 33
Rishikimi i sasive të kufizuara dhe i njësive të llogaritjes ose njësive monetare

1. Pavarësisht nga dispozitat e neni 32, Depozitari do të mbledhë një konferencë, në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni, vetëm për qëllimin e rregullimit të sasisë së specifikuar në nenin 6 dhe paragrafin 2 të neni 26 ose për zëvendësimin e njërës apo të dyja njësive të përcaktuara në paragrafët 1 dhe 3 të neni 26 me njësi të tjera. Një rregullim i sasive do të bëhet vetëm për shkak të ndryshimit të konsiderueshëm në vlerën e tyre reale.

2. Një konferencë rishikimi do të mbledhet nga Depozitari kur jo më pak se një e katërta e Shteteve Kontraktuese e kërkojnë këtë gjë.

3. Çdo vendim i konferencës do të merret nga dy të tretat e shumicës së shteteve pjesëmarrëse. Amendamenti i komunikohet nga Depozitari të gjitha Shteteve Palë Kontraktuese për pranim dhe të gjitha Shteteve Palë nënshkruese të Konventës për informacion.

4. Çdo amendament i miratuar hyn në fuqi në ditën e parë të muajit që pason përfundimin e një

periudhe njëvjeçare duke filluar nga data e pranimit të tij nga dy të tretat e Shteteve Palë Kontraktuese. Pranimi bëhet nëpërmjet depozitimit të një instrumenti formal për këtë qëllim pranë Depozitarit.

5. Pas hyrjes në fuqi të një amendamenti, një Shtet Palë Kontraktues, i cili ka pranuar amendamentin është i autorizuar të zbatojë Konventën siç është amenduar në marrëdhëniet e saj me Shtetet Palë Kontraktuese, të cilat brenda gjashtë muajsh pas miratimit të amendamentit nuk kanë njoftuar Depozitarin që ky amendament nuk është i detyrueshëm për ta.

6. Çdo instrument ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi i depozituar pas hyrjes në fuqi të një amendamenti për këtë Konventë, çmohet të zbatohet për Konventën e amenduar.

Neni 34 **Denoncimi**

1. Një Shtet Palë Kontraktues mund ta denoncojë këtë Konventë me anë të një njoftimi me shkrim drejtuar Depozitarit.

2. Ky denoncim do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit që pason përfundimin e një periudhe njëvjeçare pas datës së marrjes së njoftimit nga Depozitari ose një periudhe më të gjatë siç mund të specifikohet në njoftimin e marrë prej Depozitarit.

Bërë në Hamburg në datën 31 të muajit mars të vitit 1978, në një kopje origjinale të vetme, tekstet e të cilit në gjuhët arabe, kineze, angleze, frënge, ruse dhe spanjolle kanë të njëjtën vlerë autentikë.

Në dëshmi të sa më sipër, nënshkruesit fuqiplotë të autorizuar posaçërisht nga qeveritë e tyre respektive kanë nënshkruar këtë Konventë.

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI **I PËRBASHKËT I MIRATUAR NGA KONFERENCA E KOMBEVE TË BASHKUARA PËR** **TRANSPORTIN E MALLRAVE NË RRUGË DETARE (A/CONF. 89/13, ANEKSI 11)**

Në bazë të mirëkuptimit të përbashkët, përgjegjësia e transportuesit sipas kësaj Konvente bazohet në parimin e fajit ose pakujdesisë së paramenduar. Kjo nënkupton që, si rregull, barra e provës qëndron mbi transportuesin, por, në raste të veçanta, dispozitat e Konventës modifikojnë këtë rregull.

REZOLUTA **E MIRATUAR NGA KONFERENCA E KOMBEVE TË BASHKUARA PËR TRANSPORTIN E** **MALLRAVE NË RRUGË DETARE (A/CON. 89/13, ANEKSI III)**

Konferenca e Kombeve të Bashkuara mbi Transportin e Mallrave në Rrugë Detare,
duke vërejtur me vlerësim ftesën e përzemërt të Republikës Federale të Gjermanisë për të mbajtur Konferencën në Hamburg,

të vetëdijshëm se mjediset e vendosura në dispozicion të Konferencës dhe mikpritjes bujare ndaj pjesëmarrësve nga Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë dhe nga Free and Hanseatic city of Hamburg kanë kontribuar në shkallë të konsiderueshme në suksesin e Konferencës,

i shpreh mirënjohjen e saj Qeverisë dhe popullit të Republikës Federale të Gjermanisë, dhe duke miratuar Konventën mbi Transportin e Mallrave në Rrugë Detare mbi bazën e një draftkonvente të përgatitur nga Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, me kërkesë të Konferencës së Kombeve të Bashkuara mbi Tregtinë dhe Zhvillimin,

i shpreh mirënjohjen e saj Komisionit të Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare dhe Konferencës së Kombeve të Bashkuara mbi Tregtinë dhe Zhvillimin për kontributin e tyre të jashtëzakonshëm për thjeshtimin dhe harmonizimin e ligjit mbi transportin e mallrave në rrugë detare dhe

vendos të emërtojë Konventën e miratuar nga Konferenca si “Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi Transportin e Mallrave në Rrugë Detare, 1978” dhe

rekomandon që rregullat e përfshira në të të njihen si “Rregullat e Hamburgut”.

(Formulari i vërtetimit për faturë të paguar)

L I G J
Nr.9505, datë 3.4.2006

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KËSHILLIT MINISTOR TË KONFEDERATËS ZVICERANE PËR BASHKËPUNIMIN POLICOR NË LUFTËN KUNDËR KRIMIT”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit Ministror të Konfederatës Zvicerane për bashkëpunimin policor në luftën kundër krimit”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4839, datë 25.4.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË DHE KËSHILLIT FEDERAL TË KONFEDERATËS
ZVICERANE MBI BASHKËPUNIMIN POLICOR KUNDËR KRIMIT

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
KËSHILLIT FEDERAL TË KONFEDERATËS ZVICERIANE MBI BASHKËPUNIMIN POLICOR
KUNDËR KRIMIT

Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit Federal të Konfederatës Zviceriane, të quajtur më poshtë Palë Kontraktuese,

me qëllim për të kontribuar në zhvillimin e marrëdhënieve të ndërsjella;

të bindur për rëndësinë e madhe të bashkëpunimit policor për të luftuar krimin dhe për ta parandaluar me efektivitet atë, në mënyrë të veçantë krimin e organizuar, terrorizmin, trafikimin e paligjshëm të narkotikëve dhe substancave psikotrope dhe prekursorëve;

duke u përprekur të përcaktojnë dhe përmbushin nivelin e bashkëpunimit policor ndërmjet autoriteteve shqiptare dhe autoriteteve zviceriane;

ndërsa duke respektuar nga ana tjetër të drejtat dhe detyrimet për shtetasit e të dyja Palëve Kontraktuese, dhe

duke pasur të bëjnë me detyrimet ndërkombëtare dhe legjislacionin kombëtar të shteteve të tyre respektive,

kanë rënë dakord për sa më poshtë:

TITULLI I
QËLLIMI I MARRËVESHJES

Neni 1

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është të forcojë bashkëpunimin dypalësh policor ndërmjet Palëve Kontraktuese, zbulimin dhe hetimin e krimeve në mënyrë të veçantë ndërmjet shkëmbimit të

informacionit strategjik dhe operacional dhe kontakteve të rregullta ndërmjet autoriteteve përgjegjëse në të gjitha nivelet e duhura.

TITULLI II FUSHA E ZBATIMIT

Neni 2

Fusha e veprimtarisë kriminale

1. Bashkëpunimi, sikurse është vendosur në këtë Marrëveshje, do të lidhet me të gjitha format e aktiviteteve kriminale, në mënyrë të veçantë:

- a) krimi i organizuar;
- b) terrorizmi dhe financimi i tij;
- c) trafikimi i qenieve njerëzore dhe kontrabanda e njerëzve;
- d) krimet seksuale ndaj të miturve;
- e) krimi kompjuterik;
- f) trafikim i paligjshëm i narkotikëve, substancave psikotrope dhe prekursorëve;
- g) përvetësim i paligjshëm, zotërim i paligjshëm dhe trafikim i paligjshëm armësh, municioni dhe eksplozivash ose materialesh kimike, biologjike, radioaktive dhe materialesh bërthamore, ose mallrash dhe teknologjisë të rëndësishme strategjike, ose të teknologjisë ushtarake;
- h) krime në lidhje me objektet me vlera kulturore dhe historike;
- i) prodhimi dhe falsifikimi i parave, mjeteve të pagesës dhe dokumenteve zyrtare;
- j) pastrim parash dhe krim ekonomik;
- k) korrupsioni;
- l) krime në mjete motorike.

2. Pavarësisht nga fushat e krimit, sikurse specifikohen në paragrafin 1, kjo Marrëveshje nuk lejon autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese të bashkëpunojnë për çështje të natyrës politike, ushtarake dhe fiskale.

Neni 3

E drejta e zbatueshme

Bashkëpunimi sipas kësaj Marrëveshjeje kryhet siç parashikohet nga legjislacioni kombëtar i Palëve Kontraktuese dhe sipas dispozitave të së Drejtës Ndërkombëtare.

TITULLI III PROCEDURAT DHE FUSHAT E BASHKËPUNIMIT

Neni 4

Bashkëpunimi i përgjthshëm

Bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve kompetente sipas kësaj Marrëveshjeje mbulon fushat e mëposhtme:

- a) shkëmbimi i informacionit;
- b) koordinimi operacional;
- c) krijimi i grupeve të përbashkëta të punës;
- d) trajnimi dhe formimi profesional.

Neni 5

Shkëmbimi i informacionit

Palët Kontraktuese do të ofrojnë mbështetje të ndërsjellë nëpërmjet shkëmbimit të të dhënave dhe materialeve personale dhe jopersonale, veçanërisht mbi:

a) aktet kriminale, në mënyrë të veçantë mbi autorët e veprave penale ose personat e tjerë të përfshirë në veprat penale ashtu si edhe mbi kushtet nën të cilat është kryer një vepër penale dhe masat që janë marrë;

b) përgatitjen e akteve kriminale, veçanërisht akteve të terrorizmit drejtuar kundër interesave të Palëve Kontraktuese;

c) objektet që janë të lidhura me një krim, duke përfshirë kampione të objekteve të tilla;

d) aksionet dhe operacionet e planifikuara që mund të jenë me interes për Palën tjetër Kontraktuese;

e) dokumentacionin konceptual dhe analitik si dhe literaturën profesionale;

f) dispozitat ligjore të brendshme mbi subjektin e kësaj Marrëveshjeje dhe ndryshimet në këto dispozita;

g) njohuritë që përfitohen nga veprimet e autoriteteve kompetente, veçanërisht mbi format e reja të krimit.

Neni 6 **Koordinimi**

1. Autoritetet përgjegjëse të Palëve Kontraktuese do të marrin masa, nëse është e nevojshme, për të siguruar në territorin e tyre respektiv koordinimin e operacioneve:

a) në kërkimin për persona dhe objekte, përfshirë zbatimin e masave që synojnë zbulimin dhe bllokimin e të ardhurave dhe sendeve që rrjedhin nga aktivitetet kriminale;

b) në zbatimin e teknikave të posaçme të hetimit të tilla, si dorëzimet e kontrolluara, vëzhgimi dhe hetimet e fshehta;

c) në mbrojtjen e dëshmitarëve, viktimave, bashkëpunëtorëve të drejtësisë dhe personave të tjerë me qëllim të evitimit të rreziqeve për jetën dhe shëndetin ose ndonjë rreziku tjetër serioz që ka të bëjë me procedurat penale;

d) në planifikimin dhe zbatimin e programeve të përbashkëta për parandalimin e krimit.

2. Autoritetet përgjegjëse do të vendosin bashkërisht mbi bazë rastesh të veçanta mbi kompensimin financiar si rezultat i kostove që lindin nga zbatimi i këtij neni.

Neni 7 **Grupet e përbashkëta**

1. Autoritetet përgjegjëse të Palëve Kontraktuese do të krijojnë sipas nevojave ekipe të përziera të analizës, grupe të përbashkëta pune për kontrollin dhe mbikëqyrjen në të cilët zyrtarët e autoriteteve kompetente të një Pale Kontraktuese, pa ushtruar përgjegjësi të pakufizuar, janë aktivë me kapacitet këshillues dhe mbështetës në operacionet mbi territorin sovran të Palës tjetër Kontraktuese. Zyrtarët respektojnë instruksionet e lëshuara nga Pala në Marrëveshje në territorin e së cilës kryhen operacionet.

2. Autoritetet përgjegjëse do të vendosin bashkërisht mbi bazë rastesh të veçanta mbi kompensimin financiar si rezultat i kostove që lindin nga zbatimi i këtij neni.

Neni 8 **Asistenca dhe shërbimi**

1. Palët Kontraktuese u japin zyrtarëve nga Pala tjetër në marrëveshje që operojnë në territoret e tyre sipas nenit 7, të njëjtën mbrojtje dhe asistencë sikurse zyrtarëve të vet.

2. Zyrtarët e Palëve Kontraktuese mbeten subjekt i legjislacionit të tyre kombëtar në lidhje me kushtet e punësimit dhe afatet e shërbimit dhe statusin e tyre juridiko-disiplinor.

Neni 9 **Detyrimi civil lidhur me zyrtarët**

1. Në rastet kur, në pajtim me nenin 7, zyrtarët e një Pale Kontraktuese janë duke operuar në territorin sovran të Palës tjetër, Pala e parë do të jetë përgjegjëse për ndonjë dëm të shkaktuar nga ana e tyre gjatë operimit, në përputhje me ligjin e Palës në territorin e së cilës ato janë duke operuar.

2. Pala, në territorin e së cilës u shkaktua dëmi i përmendur në paragrafin 1, do ta shlyejë këtë dëm sipas kushteve që zbatohen për dëmin e shkaktuar nga zyrtarët e vet.

3. Pala, zyrtarët e së cilës kanë shkaktuar dëm ndaj ndonjë personi në territorin e Palës tjetër do t'i rimbursojë kësaj të fundit plotësisht çdo shumë që kjo i ka paguar viktimave ose personave të njohur si përfaqësues të tyre.

4. Pa cenuar ushtrimin e të drejtave të saj karshi palëve të treta dhe me përjashtim të paragrafit 3, secila Palë nuk do të kërkojë në rastin e parashikuar në paragrafin 1 rimbursimin për dëmet që ajo ka pësuar nga Pala tjetër.

Neni 10

Detyrimi penal lidhur me zyrtarët

Gjatë operacioneve të cituara në neni 7 zyrtarët e një Pale, e cila nuk është Pala që operon, do të konsiderohen si zyrtarë të Palës që operon për sa i përket krimeve të kryera kundër tyre ose nga vetë ata.

Neni 11

Trajnimi dhe formimi profesional

1. Palët Kontraktuese mbështesin njëra-tjetrën përmes masave në sferën e trajnimit dhe formimit profesional, veçanërisht nëpërmjet:

a) pjesëmarrjes në kurse trajnimi në gjuhën/gjuhët zyrtare të Palës tjetër Kontraktuese ose në gjuhën angleze;

b) mbajtjes së seminareve të përbashkëta, stërvitjeve të përbashkëta dhe kurseve të trajnimit;

c) trajnimit të specialistëve;

d) shkëmbimit të ekspertëve dhe koncepteve të trajnimit;

e) pjesëmarrjes së vëzhguesve në stërvitje.

2. Gjithashtu, Palët Kontraktuese do të inkurajojnë ndarjen e eksperiencave dhe njohurive në të gjitha format e tjera.

Neni 12

Procedurat dhe kostot

1. Kërkesat për informacion, masa të koordinuara ose për mjete të tjera të asistencës do të bëhen më shkrim dhe duke deklaruar arsyet për kërkesën. Këto kërkesa mund të transmetohen, nëse është e nevojshme, nëpërmjet faksit ose e-mailit, duke parashikuar që është e pranueshme për të vepruar kështu bazuar në përmbajtjet e kërkesës. Palët Kontraktuese në raste emergjencash mund të bëjnë një kërkesë gojore të pasuar menjëherë nga konfirmimi me shkrim.

2. Autoritetet kompetente mund të informojnë njëra-tjetrën rreth rasteve specifike pa qenë e nevojshme të bëjnë një kërkesë për informim kur këto raste mund të ishin të rëndësishme në ndihmën për t'u mbrojtur kundër rreziqeve konkrete për rendin dhe sigurinë publike ose për të luftuar kundër krimit dhe për ta parandaluar atë.

3. Autoritetet kompetente i japin njëra-tjetrës asistencë të drejtpërdrejtë, me kusht që kërkesa për asistencë nuk do t'i përkasë juridiksionit të autoriteteve gjyqësore në pajtim me legjislacionin kombëtar. Nëse autoriteti policor i cili ka marrë një kërkesë për asistencë nuk është përgjegjës për t'u marrë me kërkesën, ai do t'ia përcjellë kërkesën autoritetit përgjegjës.

4. Autoritetet përgjegjëse të Palës Kontraktuese të Kërkuar do t'i përgjigjen kërkesës së specifikuar në paragrafin 1 sa më shpejt të jetë e mundur. Autoritetet kompetente të Palës Kontraktuese të Kërkuar mund të kërkojnë për më tepër informacion nëse është e nevojshme për të plotësuar kërkesën.

5. Çdo Palë Kontraktuese mund të refuzojë, plotësisht ose pjesërisht, një kërkesë për asistencë nëse ajo vlerëson se duke e plotësuar atë kërkesë mund të kërcënohet sovraniteti, siguria ose ndonjë interes tjetër jetik për shtetin e saj, ose nëse kërkesa nuk është në përputhje me legjislacionin e saj kombëtar, ose nëse kërkesa cenon detyrimet e saj që burojnë nga marrëveshjet ndërkombëtare. Me synim që të përmbushin kërkesën, Palët Kontraktuese mund të përcaktojnë kushtet në të cilat kushtëzohet përmbushja e saj.

6. Pala e Kërkuar do të informojë menjëherë me shkrim Palën Kërkuese duke deklaruar arsyet në rast të refuzimit të një kërkesë ose plotësimit të pjesshëm të saj.

7. Kostot që rrjedhin, në zbatim të një kërkesë, do të përballohen nga Pala Kontraktuese e Kërkuar, me përjashtim të nenit 6, paragrafi 2 dhe nenit 7, paragrafi 2, ku autoritetet kompetente vendosin bashkërisht mbi bazë rasti të veçantë për kompensimin financiar.

TITULLI IV ATASHETË POLICORË

Neni 13

1. Autoritetet përgjegjëse të Palëve Kontraktuese mund të lidhin marrëveshje të posaçme në lidhje me caktimin e atasheve policorë për periudha kohe të përcaktuara ose të papërcaktuara për në shtetin e Palës tjetër Kontraktuese. Atasheve policorë do t'u jepet statusi i përfaqësuesve diplomatikë në pajtim me konventën e Vjenës të 18 prillit 1961 mbi Marrëdhëniet Diplomatike.

2. Qëllimi i caktimit të atasheve policorë për në shtetin e Palës tjetër Kontraktuese është që të përmirësohet dhe të përshpejtohet bashkëpunimi policor, në mënyrë të veçantë me anë të mbështetjes për procedurat e asistencës së ndërsjellë policore dhe gjyqësore në çështjet penale.

3. Atashetë policorë do të jenë aktivë me cilësi këshillimi dhe mbështetje, duke mos ushtruar përgjegjësi të pakufizuara. Ata japin informacion dhe kryejnë detyra në pajtim me instruksionet që ato marrin nga Pala në marrëveshje që i dërgon ato.

TITULLI V MBROJTJA DHE TRANSMETIMI I TË DHËNAVE TEK TË TRETËT

Neni 14

Mbrojtja e të dhënave

Për qëllim të mbrojtjes së të dhënave me karakter personal që shkëmbehen nga Palët Kontraktuese brenda kuadrit të kësaj Marrëveshjeje bashkëpunimi dhe në përputhje me legjislacionin kombëtar të shteteve të Palëve Kontraktuese dhe me detyrimet e tyre respektive ndërkombëtare, do të respektohen kushtet e mëposhtme:

a) Të dhënat e klasifikuara mbi individët dhe përshkrimet e personalitetit, sikurse përcaktohet në nenin 6 të Konventës së Këshillit të Europës të datës 28 janar 1981 për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale, mund të shkëmbehen vetëm nëse është absolutisht e nevojshme dhe së bashku me të dhëna të tjera policore.

b) Pala në Marrëveshje e cila i merr ato, mund të përdorë të dhënat vetëm për qëllimet e përcaktuara në këtë Marrëveshje dhe sipas kushteve të përcaktuara nga Pala në Marrëveshje që transmeton të dhënat; këto të dhëna mund të përdoren për qëllime të tjera vetëm me autorizim paraprak me shkrim të bëra nga Pala që transmeton të dhënat dhe në përputhje me legjislacionin e Palës Kontraktuese që merr të dhënat.

c) Mbi bazën e kërkesës të Palës Kontraktuese që transmeton të dhënat, Pala në Marrëveshje që merr të dhënat do të japë informacion mbi përdorimin e të dhënave të transmetuara dhe rezultatet e përfituara si rrjedhim.

d) Të dhënat mund të përdoren vetëm nga autoritetet gjyqësore ose policore ose nga ndonjë autoritet tjetër i caktuar nga Palët Kontraktuese për qëllim të luftës kundër krimit. Një listë e autoriteteve të duhura do t'i komunikohet Palës tjetër Kontraktuese. Të dhënat nuk mund të transferohen tek autoritete të tjera me përjashtim kur ka një aprovim me shkrim të Palës Kontraktuese që transmeton të dhënat.

e) Pala në Marrëveshje që transmeton të dhënat do të marrë përsipër të sigurojë që të dhënat e transmetuara janë të sakta, dhe do të verifikojë nëse transmetimi është i nevojshëm dhe proporcional me qëllimin e paracaktuar. Për këtë, është e nevojshme të respektohen legjislacionet kombëtare të të dyja Palëve, gjë që mund të kufizojë transmetimin e të dhënave. Nëse më vonë konstatohet që janë transmetuar të dhëna të pasakta ose të paautorizuara, Pala në Marrëveshje që mori të dhënat duhet të njoftohet menjëherë. Pala në Marrëveshje që mori të dhënat do t'i korrigjojë gabimet ose, në rastin kur të dhënat nuk duhej të ishin transmetuar, do t'i asgjësojë ato.

f) Personat, të dhënat personale të të cilëve u transmetuan, me kërkesën e tyre do të marrin informacion rreth të dhënave të transmetuara dhe përdorimit të tyre të paracaktuar. Publikimi i informacionit duhet të bëhet në pajtim me legjislacionin kombëtar të Palës Kontraktuese ku është bërë kërkesa. Kërkesa do të plotësohet vetëm mbi bazën e pëlqimit paraprak me shkrim të Palës tjetër Kontraktuese.

g) Kur transmetohen të dhënat, Pala në Marrëveshje që i transmeton ato mund të njoftojë Palën tjetër Kontraktuese për afatin e fundit për asgjësimin e tyre në përputhje me legjislacionin kombëtar të shtetit të saj. Pavarësisht afatit, të dhënat duhet të fshihen menjëherë sapo të pushojnë së qeni të nevojshme. Pala në Marrëveshje që i transmeton të dhënat duhet të informohet rreth fshirjes së të dhënave të transmetuara dhe rreth arsyeve për fshirjen. Në rastin e pushimit së vepruari të kësaj Marrëveshjeje, të gjitha të dhënat që janë marrë mbi bazën e saj do të eliminohen.

h) Të dyja Palët Kontraktuese do të regjistrojnë transmetimin, marrjen dhe fshirjen e të dhënave. Regjistrimi do të tregojë në mënyrë të veçantë qëllimin e transmetimit, autoritetet e përfshira dhe arsyet për fshirjen.

i) Sipas legjislacionit të saj Pala në Marrëveshje nuk mund t'ia hedhë përgjegjësinë e saj paditësit me anë të deklarimit që dëmi u shkaktua nga transmetimi i të dhënave të pasakta ose të paautorizuara. Nëse Palës Kontraktuese i kërkohet të paguajë kompensim për arsye të dëmit të shkaktuar nga përdorimi i të dhënave të transmetuara në mënyrë të pasaktë ose të dhënave të paautorizuara, Pala në Marrëveshje që transmeton të dhënat do ta rimbursojë Palën Kontraktuese që merr të dhënat për vlerën totale të kompensimit.

j) Të dyja Palët Kontraktuese do të kenë detyrën për të mbrojtur me efektivitet të dhënat e transmetuara kundër së drejtës së paautorizuar për t'i njohur dhe përdorur ato, dhe tjetërsimit ose publikimit të paautorizuar.

Neni 15

Mbrojtja e informacionit të klasifikuar dhe transmetimi tek të tretët

1. Pala në Marrëveshje që transmeton të dhënat do të vendosë kushte për përdorimin e informacionit, nëse ai konsiderohet i klasifikuar në kuadrin e legjislacionit të saj kombëtar. Pala në Marrëveshje që merr të dhënat duhet të respektojë mbrojtjen e nevojshme për informacionin e klasifikuar. Këto kushte mund të ndryshohen ose klasifikimi mund të hiqet në çdo kohë nga Pala në Marrëveshje, që transmeton të dhënat.

2. Informacioni i klasifikuar mund të përdoret vetëm nga policia dhe autoritetet e tjera përgjegjëse për parandalimin dhe luftimin e krimit, të cilët janë të autorizuar të përdorin të dhëna të klasifikuara. Të dhënat e klasifikuara mund t'i transmetohen vetëm autoriteteve të tjera ose shteteve të treta me miratimin paraprak me shkrim të Palës Kontraktuese që transmeton të dhënat. Këto të dhëna mund të përdoren vetëm nga persona të cilët kërkojnë informacion me qëllim që të përmbushin detyrat e tyre të punës dhe të cilët janë të autorizuar të kenë të drejtë në shfrytëzimin e këtyre të dhënave sipas legjislacionit kombëtar.

3. Çdo keqpërdorim në lidhje me të dhënat e klasifikuara dotë njoftohet me shkrim menjëherë.

TITULLI VI DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 16 **Autoritetet përgjegjëse**

1. Autoritetet kompetente për qëllim të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje janë:
 - Për Republikën e Shqipërisë, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit në Ministrinë e Brendshme, dhe
 - për Konfederatën Zvicerane, Zyra e Policisë Federale në Departamentin Federal të Drejtësisë dhe Policisë,të cilat do të bashkëpunojnë drejtpërdrejt dhe në mënyrë operative në kuadrin e kompetencave të tyre respektive.
2. Autoritetet përgjegjëse do të shkëmbejnë numrat e tyre përkatës të telefonit, faksit ose adresa të tjera kontakti dhe caktojnë personin e kontaktit, i cili mundësisht ka njohuri mbi gjuhën e Palës tjetër Kontraktuese, brenda 30 ditëve pasi Marrëveshja të ketë hyrë në fuqi.
3. Autoritetet kompetente do të njoftojnë njëra-tjetrën pa vonesë për ndryshime në të dhënat e komunikuara sipas paragrafëve 1 dhe 2.

Neni 17 **Gjuha**

Nëse nuk bihet dakord ndryshe nga autoritetet kompetente, kjo Marrëveshje do të zbatohet në gjuhën angleze.

Neni 18 **Takimet e ekspertëve**

Një grup i përbashkët nga zyrtarë të nivelit të lartë nga Palët Kontraktuese do të takohen sipas nevojave me qëllim për të bërë bilancin e arritjeve të bashkëpunimit të kryer në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje, për të vlerësuar cilësinë e saj, për të diskutuar strategji të reja dhe për të vendosur nëse nevojitet që bashkëpunimi të plotësohet ose zhvillohet më tej.

Neni 19 **Marrëveshje plotësuese**

Për qëllim të zbatimit dhe zhvillimit të bashkëpunimit në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje, autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese mund të lidhin marrëveshje të mëtejshme policore në bazë dhe brenda kuadrit të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 20 **Raporti përkundrejt marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare**

Kjo Marrëveshje nuk do të pengojë detyrimet e shteteve të Palëve Kontraktuese që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare, dypalëshe ose shumëpalëshe nëpërmjet të cilave secili nga shtetet e Palëve Kontraktuese mund të jetë i kushtëzuar.

Neni 21 **Hyrja në fuqi, Pushimi së vepruari dhe Denoncimi**

1. Kjo Marrëveshje u nënshtrohet formaliteteve të aprovimit të brendshëm në pajtim me legjislacionin kombëtar të secilës Palë Kontraktuese dhe do të fillojë së vepruari në ditën e marrjes së shkëmbimit të fundit të notave që konfirmojnë këto aprovime të brendshme.

2. Kjo Marrëveshje është e vlefshme për një periudhë kohe të pakufizuar. Ajo mund të denoncohet në çdo kohë nga secila prej Palëve Kontraktuese me anë të një njoftimi me shkrim. Kjo marrëveshje do të pushojë së qeni e vlefshme gjashtë muaj pas datës së dorëzimit të këtij njoftimi me shkrim Palës tjetër Kontraktuese.

Bërë në Tiranë, më 21.9.2005 në dy origjinale, secila në gjuhët shqip dhe gjermanisht, duke qenë të dyja njëëlloj të barasvlefshme.

L I G J
Nr.9510, datë 10.4.2006

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES FINANCIARE NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE ARTIGIANCASSA S.P.A. PËR FINANCIMIN E PROGRAMIT “PERIFERITË URBANE TË TIRANËS – KOMPONENTI INFRASTRUKTUROR”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe ARTIGIANCASSA S.P.A. për financimin e programit “Periferitë urbane të Tiranës – komponenti infrastrukturor”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4844, datë 25.4.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE FINANCIARE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE ARTIGIANCASSA S.P.A

Euro 3 000 000, 00

PROGRAMI PËR PERIFERITË URBANE TË TIRANËS
KOMPONENTI INFRASTRUKTUROR

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë (në vijim i quajtur si “Huamarrësi”), i përfaqësuar nga Ministria e Financave nga njëra anë, dhe Artigiancassa S.p.A., e listuar në regjistrin e bankave me një kapital 35 000 000, 00 me zyrë të regjistruar në Romë, Via Crescenzo del Monte 25, me regjistrer të kompanive, kodi i taksës no.01158450583, TVSH no.00968081000 (në vijim e quajtur “Artigiancassa”), si administratori i Fondit Qarkullues për Bashkëpunim Zhvillimi në emër të

Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave të Italisë, i krijuar në përputhje me nenin 26 të ligjit italian nr.227 të 24 majit 1977 dhe më tej duke iu referuar nenit 6 të ligjit italian nr.49 të 26 shkurtit 1987, përfaqësuar nga z.Carlo Larcinese, nga ana tjetër. (Artigiancassa dhe Huamarrësi së bashku do të quhen në vijim si “Palët”),

kanë vendosur këtë Marrëveshje financiare

Neni 1 **Përkufizime**

Në këtë Marrëveshje dhe në anekset përkatëse, termat e mëposhtëm do të kenë kuptimet si vijojnë:

“Njohje e Borxhit”, do të thotë deklarimi që i referohet nenit 10, sipas të cilit Huamarrësi merr përsipër të shlyejë në favor të Artigiancassa kapitalin plus interesin që i detyrohet në zbatim të kësaj Marrëveshjeje;

“Banka Agjente” do të thotë institucioni financiar (Artigiancassa), e cila do të përfshihet në këto aktivitete:

- kontroll të dokumentacionit kontraktues;
- veprimet disbursuese;
- veprime të pagesave.

“Marrëveshje” do të thotë Marrëveshja financiare aktuale, preambola dhe anekset përkatëse që formojnë një pjesë integrale;

“Banka shqiptare” do të thotë banka e caktuar nga Huamarrësi si banka korresponduese e Artigiancassa që vepron si Bankë Agjente për qëllime të kësaj Marrëveshjeje;

“Dokumentacioni kontraktues” do të thotë dokumentacioni që i referohet kontratës/kontratave të furnizimit (p.sh.faturat, llogaritë e ngarkesave, listat e paketimeve, punimet në proces;

“Periudha falas” do të thotë periudha që zgjat 204 muaj, duke filluar nga data e disbursimit të parë;

“Autoritetet Kompetente Italiane” do të thotë Ministria e Ekonomisë dhe e Financave dhe/ose Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Italisë dhe/ose ndonjë njësi kompetente tjetër e Republikës Italiane, e emëruar për qëllime të kësaj Marrëveshjeje;

“MAE/DGCS” do të thotë Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Italisë-Drejtoria e Përgjithshme për Bashkëpunim dhe Zhvillim;

“Program” do të thotë projekti që lidhet me “programin për periferitë urbane të Tiranës-Komponenti infrastrukturor” i miratuar në bazë të Marrëveshjes Qeveritare nga Qeveria e Republikës së Italisë dhe Qeveria e Republikës së Shqipërisë, e financuar krejtësisht në kuptimin e kredisë së butë;

“Njësia e zbatimit të projektit (NJZP)” do të thotë njësia teknike e ngritur në Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit për zbatimin e programit;

“Hua e Butë” do të thotë financimi që Artigiancassa, në bazë të autorizimit të lëshuar nga Ministria e Ekonomisë dhe e Financave dhe sipas propozimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme, do të akordojë në termat dhe kushtet e ofruara nga neni 1 dhe neni 3 i kësaj Marrëveshjeje;

“Kontrata/kontratat e furnizimeve” do të thotë kontrata/kontratat tregtare që lidhen me furnizimin e mallrave dhe/ose të shërbimeve nga eksportuesit italianë tek importuesit shqiptarë, që kanë të bëjnë me realizimin e programit.

Neni 2 **Hyrje**

2.1 Në kuptim të Marrëveshjes së njohur si “Marrëveshje Qeveritare” (në vijim e referuar si “Marrëveshja Qeveritare”) e nënshkruar më 29 janar 2004, ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë, kjo e fundit është angazhuar të financojë programin që lidhjet me “Periferitë urbane të Tiranës-Komponenti infrastrukturor) me anë të një huaje të butë me një maksimum prej 3 000 000,00 (tre milionë) euro.

2.2 Në kuptimin e kësaj Marrëveshjeje palët kanë si qëllim: (i) të zbatojnë financimet që

lidhen me huanë e butë të përcaktuar në Marrëveshjen Qeveritare dhe (ii) të rregullojnë të drejtat dhe detyrimet e tyre në përputhje me Marrëveshjen Qeveritare.

2.3 Ministria e Ekonomisë dhe e Financave e Qeverisë së Republikës të Italisë, në bazë të propozimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Italisë, me dekretin nr.79144, datë 18 korrik 2005 ka autorizuar Artigiancassa t'i akordojë Huamarrësit një hua të butë në termat dhe kushtet e përcaktuara në nenet 3 dhe 6 të kësaj Marrëveshjeje (në vijim e referuar si "Hua e Butë") për qëllime të financimit të programit.

2.4 Artigiancassa për qëllime të kësaj Marrëveshjeje do të veprojë si Bankë Agjente dhe banka shqiptare do të jetë Raiffeisen Bank në Shqipëri

Neni 3 **Hua e Butë**

3.1 Artigiancassa i akordon Huamarrësit dhe Huamarrësi nga kjo pranon Huanë e Butë me kushtet e mëposhtme:

- Shuma: maksimum deri në 3 000 000, 00 (tre milionë) euro;
- Kohëzgjatja: 38 vjet;
- Shlyerja: 42 vjet (dyzet e dy) këste të principalit të barabarta gjysmëvjetore të njëpasnjëshme, i pari i të cilëve bëhet i pagueshën 210 (dyqind e dhjetë) muaj prej datës së disbursimit të parë;

- Norma e interesit nominale 0.10% në vit (zero pikë dhjetë për qind) e pagueshme në fund të çdo periudhe të 6 (gjashtë) muajve prej datës së çdo tërheqje;

- Qëllimi i kredisë "Programi për periferitë urbane të Tiranës – Komponentë infrastrukturorë.

3.2 Huaja e Butë do të përdoret për blerjen e mallrave dhe të shërbimeve me origjinë italiane. Një shumë maksimale prej 40 (dyzet)% e shumës referuar Huasë së Butë mund të përdoret për të mbuluar kostot lokale dhe të importimit të mallrave dhe shërbimeve me origjinë prej vendeve në zhvillim.

Secila dhe çdo kontratë, që lidhet me kostot lokale dhe importimin e mallrave, që kanë origjinën nga vendet në zhvillim do të negociohet vetëm përmes dhe të nënshkruhet nga një kontraktor/eksportues kryesor italian. Kontratat e furnizimit do të jenë në euro.

3.3 Huaja e Butë nuk mund të përdoret për të financuar:

Taksat lokale, taksat doganore dhe TVSH-në.

3.4 Kontratat e furnizimit që lidhen me programin sipas nenit 2.1 do të prokurohen përmes ofertave publike të rezervuara për kompanitë italiane mbi bazën e procedurave të ofruara në: "Manualin e procedurave" (të përshtatura nga Komisioni European në 23 dhjetor 2002) lidhur me shërbimet, furnizimet dhe kontratat e punimeve të financuara nga buxheti i përgjithshëm i Komisionit European në kontekstin e bashkëpunimit me vendet e treta".

3.5 Huaja e Butë do të bëhet e disponueshme në përputhje me termat dhe kushtet e vendosura në këtë Marrëveshje.

Neni 4 **Bërja efektive e Marrëveshjes financiare**

4.1 Kjo Marrëveshje do të bëhet efektive pasi Artigiancassa të ketë marrë prej Huamarrësit dokumentet e mëposhtme përmes Ambasadës Italiane-Ambasada/Zyra e Bashkëpunimit:

i) Një deklaratë nga autoriteti kompetent i Qeverisë së Republikës të Shqipërisë duke pasqyruar autoritetin e Huamarrësit për të nënshkruar në emër të Qeverisë shqiptare këtë Marrëveshje nga një person i autorizuar sipas rregullit në përputhje me ligjet dhe rregullat në fuqi dhe vepruese në Shqipëri dhe të marrë përsipër detyrimet e lindura nga kjo Marrëveshje.

ii) Emërimin me shkrim nga një autoritet kompetent i Huamarrësit i personit/personave të autorizuar në mënyrë të rregullt për ta nënshkruar këtë Marrëveshje (të vërtetuar nga Ambasada Italiane në Tiranë, Ambasada/Zyra e Bashkëpunimit), kërkesa për financimin e kontratës së furnizimit në formën e aneksit A dhe njohjen e borxhit në formën e aneksit C referuar nenit 10 më poshtë. Një

përcaktim i tillë duhet të specifikojë emrin dhe zyrën e këtij personi/personave dhe të përmbajë “specimentin” azhurnuar të firmave të tyre. Ndonjë ndryshim i kësaj (nëse ka ndonjë) duhet të transmetohet në kohë nga Huamarrësi tek Artigiancassa.

4.2 Artigiancassa, pasi të ketë marrë dokumentet e lartpërmendura dhe të jetë plotësisht e kënaqur me to, do të njoftojë Huamarrësin dhe bankën shqiptare me anë të letrës ose faksit, i cili pastaj duhet të pasohet nga një letër e konfirmuar, datën në të cilën kjo Marrëveshje do të bëhet efektive.

Neni 5

Termat për disbursimet e Huasë së Butë

5.1 Periudha e disbursimit të Huasë së Butë do të jetë 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj nga data e disbursimit të parë. Një periudhë e tillë mund të zgjatet nga Artigiancassa. Pavarësisht sa më sipër Artigiancassa nuk mund të zgjasë periudhën e disbursimit, në rast se Huamarrësi ose Autoriteti Kompetent Italian nuk janë dakord për një shtyrje të tillë dhe të kenë njoftuar kështu me shkrim Artigiancassa së paku 30 (tridhjetë) ditë kalendarike para skadimit të datës së periudhës së disbursimit.

5.2 Në rast se periudha e disbursimit ka skaduar dhe nuk mund të zgjatet, Artigiancassa pasi të jetë konsultuar me Autoritetet Kompetente Italiane do të informojë Huamarrësin për anulimin e angazhimit të Artigiancassa-s në lidhje me fondet e papërdorura.

Neni 6

Kushtet dhe modalitetet për disbursimin e Huasë së Butë

6.1 Huaja e Butë mund të përdoret nga Huamarrësi, pasi të plotësojë kushtet e mëposhtme:

i) autorizimin e dhënë nga Autoriteti Kompetent Italian për të alokuar kontratën/kontratat e furnizimit të Huasë së Butë;

ii) rezultate të kënaqshme nga kontrolli i bërë nga Artigiancassa sipas nenit 6.2(i) më poshtë;

iii) marrjen nga Artigiancassa të kërkesës së financimit të kontratës së furnizimit të parashikuar nga neni 7.1 më poshtë.

6.2 Pas marrjes së autorizimit të përmendur në pikën 6.1 (i) më sipër, Artigiancassa do të kryejë menjëherë veprimet si më poshtë:

i) Të bëjë kontrollin mbi bazën e kërkesës parashikuar nga Autoriteti Kompetent Italian mbi eksportuesin italian dhe mbi individët/kompanitë italiane, nëse ka, të përfshirë me organizatat lokale dhe mbi kontratën/kontratat e furnizimit. Në lidhje me kontratën/kontratat e furnizimit, Artigiancassa do të verifikojë që ato janë në përputhje me termat dhe kushtet e Huasë së Butë dhe që ato janë mjaftueshmërisht të detajuara për sa i përket zërave të kostove/çmimeve në mënyrë që të lejojë kontrollet sipas nenit 8.3.

ii) Të njoftojë Huamarrësin dhe bankën shqiptare për marrjen e autorizimit sipas nenit 6.1 (i) më sipër dhe t'i kërkojë bankës shqiptare të nisë kërkesën e parashikuar sipas nenit 7.1.

6.3 Rezultatet e suksesshme të kontrollit të bërë nga Artigiancassa sipas nenit të mësipërm 6.2 (i), do të sjellë alokimin e kontratës/kontratave të furnizimit tek Huaja e Butë. Financimi i kontratës së furnizimit do të bëhet vetëm pas plotësimit të kushteve të vendosura sipas nenit 6.1 (iii).

6.4 Artigiancassa do të njoftojë Huamarrësin, bankën shqiptare, NJZP-në dhe eksportuesin italian për alokimin, si dhe gjithashtu për financimin e kontratës/kontratave të furnizimit.

Neni 7

Kërkesa për financimin e kontratës së furnizimit

7.1 Pas njoftimit të rezultatit të kënaqshëm të kontrollit sipas nenit 6.2 (i) banka shqiptare duhet t'i transmetojë Artigiancassa-s një kërkesë për financimin e kontratës së furnizimit të nevojshme për pagesat e parashikuara në çdo kontratë furnizimi. Me anë të një kërkesë të tillë, e cila duhet të jetë në formën e aneksit A, Huamarrësi do të vërtetojë që kontrata/kontratat e furnizimit është/janë e/të pranueshme për t'u financuar dhe do të marrë përsipër t'i rimbursojë Artigiancassa-s shumën e disbursuar.

7.2 Kërkesa për financim të kontratës së furnizimit të bërë sipas nenit 7.1 do të merret në afatin e caktuar dhe asnjëherë më vonë se gjashtë muaj prej datës së njoftimit prej Artigiancassa-s, të parashikuar në bazë të nenit 6.4 më sipër, ose kushtit (nëse ka ndonjë) të shprehur në kontratën e

furnizimit. Pas skadimit të periudhës së lartpërmendur Artigiancassa, pas konsultimit me Autoritetin Kompetent Italian, do të konsiderojë anulimin e mundshëm të kontratës/kontratave të furnizimit të alokuara tek Huaja e Butë.

Neni 8 **Disbursimet**

8.1 Kërkesa për financimin e çdo kontrate furnizimi e parashikuar sipas nenit 7 do të bëhet nga banka shqiptare në raport me çdo pagesë për t'u bërë në përputhje me kushtet e shprehura në kontratën e furnizimit, pas dorëzimit të dokumentacionit kontraktues.

8.2 Eksportuesi italian do të dorëzojë dokumentacionin kontraktues dhe do të kërkojë disbursimin e shumës përkatëse në përputhje me kontratën e furnizimit në formën e aneksit B. Një kopje origjinale e dokumentacionit kontraktues do t'i dërgohet në të njëjtën kohë nga Artigiancassa bankës shqiptare dhe NJZP-së.

8.3 Brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike prej datës së dërgimit nga Artigiancassa të dokumentacionit kontraktues të mësipërm, NJZP do të njoftojë me shkrim Artigiancassa-n dhe me një kopje bankën shqiptare për përputhjen e furnizimit të mallrave dhe/ose shërbimeve me dokumentacionin kontraktues përkatës.

8.4 Në vijim të marrjes së çdo kërkesë për disbursim, Artigiancassa do të kontrollojë dokumentacionin kontraktues. Një kontroll i tillë do të përfshijë përputhshmërinë e dokumentacionit kontraktues me kontratën e furnizimit përkatës.

8.5 Pas çdo hetimi të suksesshëm të bërë sipas nenit 8.3 dhe kontrolli të suksesshëm të bërë sipas nenit 8.4, Artigiancassa do të disbursojë shumën përkatëse në llogari brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve kalendarike prej datës së marrjes të çdo kërkesë për disbursim dhe konfirmon me telex ose fax në bankën shqiptare dhe Ministrinë e Financave për shumën totale të disbursimit dhe datën në të cilën i është kredituar fondi eksportuesit/eksportuesve italianë.

8.6 Artigiancassa do t'i bëjë pagesat në favor të eksportuesit/eksportuesve italian/ë dhe do të marrë prej eksportuesit/eksportuesve italian/ë të tillë faturën e shkarkimit të bërë sipas aneksit D në dy origjinale, njëra prej të cilave do t'i dorëzohet bankës shqiptare.

8.7 Në vijim të çdo pagese në favor të eksportuesit/eksportuesve italianë, Artigiancassa do t'i dërgojë Huamarrësit dhe bankës shqiptare një pasqyrë të përditësuar të shlyerjeve, e cila të tregojë të gjitha shumat e disburzuara deri në dhe përfshirë disbursimin e fundit, duke treguar datat përkatëse të tyre në përputhje me nenin 9 më poshtë. Huamarrësi do të konfirmojë me shkrim pranimin e tij për pasqyrën e mësipërme të pagesave të përmendura më lart.

Neni 9 **Shlyerja e Huasë së Butë dhe pagesa e interesit**

9.1 Çdo shumë e disburzuar do të ripaguhet në përputhje me pasqyrën e shlyerjeve në 42 (dyzet e dy) këste të njëpasnjëshme të barabarta të ndara në çdo gjashtë muaj (më poshtë të quajtura si këste të principalit), i pari i të cilëve do të bëhet i pagueshëm 210 (dyqind e dhjetë) muaj pas disbursimit të parë. Artigiancassa do t'i dërgojë Huamarrësit dhe bankës shqiptare pasqyrën e shlyerjeve në përputhje me nenin 8.7.

9.2 Për këstet e principalit të kredituara efektivisht, të papaguara, interesi i vonesës do të llogaritet me një normë vjetore prej 0.1% (zero pikë një për qind) e barabartë me 0.05% (zero pikë zero pesë për qind) për gjysmën e vitit, prej datës në të cilën fondet kanë qenë kredituar deri në datën e shlyerjes së këstit të fundit të principalit. Interesi do të llogaritet në numrin e ditëve aktualisht të kaluara mbi bazën e muajit tridhjetë ditësh dhe të një viti prej treqind e gjashtëdhjetë ditësh (30/360).

9.3 Gjatë periudhës së shlyerjes, interesi do të paguhet në të njëjtën datë të përcaktuar për këstin e principalit. Gjatë periudhës falas, interesi do të paguhet çdo 6 (gjashtë) muaj në datat korresponduese, në ditë dhe muajt, të datave të shlyerjes së këstit të principalit. Kësti i parë i interesit mund t'i referohet një periudhe prej më pak se gjashtë muajsh. Megjithatë, nëse kjo periudhë do të jetë më pak se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike, kësti i interesit korrespondues do të paguhet së bashku me këstin e interesit pasues. Kësti i parë i interesit, që lidhet me një periudhë prej më shumë se gjashtë muaj ose më pak se gjashtë muaj do të llogaritet mbi bazën e ditëve aktuale që numërohen midis datës së pagesave së tij, mbi bazën e një periudhe gjashtëmujore të 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditëve

kalendarike.

9.4 Pagesa e interesit që lidhet me çdo disbursim duhet të bëhet në datat e përcaktuara të paraqitura në pasqyrën e pagesave të parashtruar në nenin 8.7 deri në datën e dorëzimit të njohjes së borxhit referuar nenit 10 më poshtë; për periudhën pasuese shlyerja e principalit dhe pagesat e interesit do të bëhen në datat e përcaktuara të treguara në pasqyrën e shlyerjeve bashkëngjitur njohjes së borxhit të lartpërmendur.

9.5 Banka shqiptare në emër të Huamarrësit merr përsipër të bëjë pa vonesë të gjitha pagesat dhe shyerjet që rezultojnë nga kjo Marrëveshje, si dhe gjithashtu nga njohja e borxhit, në datën e përcaktuar aktuale, për shumën korresponduese në euro, në favor të Artigiancassa ose personit/personave të autorizuar nga ajo. Shuma të tilla do të kreditohen pa zbritjet e ndonjë banke dhe/ose të normës të shkëmbimit dhe/ose taksave dhe pa lajmërim prej saj nga Artigiancassa ose personat e autorizuar prej saj.

Neni 10

Dorëzimi i njohjes së borxhit

10.1 Brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve kalendarike prej datës së skadimit të disbursimit të fundit të Huasë së Butë të shprehur në nenin 5.1, Huamarrësi do t'i dorëzojë Artigiancassa-s njohjen e borxhit të nënshkruar siç duhet dhe të sigluar në çdo faqe në formën e aneksit C.

10.2 Pasqyra e shlyerjeve të shprehura në njohjen e borxhit do të kompletohet duke mbledhur të gjitha këstet e principalit dhe të interesit akoma të pamaturuara dhe këstet të cilat janë maturuar, por nuk janë paguar në datën e dorëzimit të njohjes së borxhit, të parashikuar në pasqyrën e shlyerjeve përkatëse për çdo disbursim, në përputhje me kushtet e nenit 8.7.

10.3 Artigiancassa do të depozitojë njohjen e borxhit për regjistrim dhe administrim të saj dhe herë pas here do të shënojë në njohjen e borxhit pagesat e principalit dhe të interesit së bashku me këstet e mundshme, të cilat janë maturuar, por nuk janë paguar. Sapo të gjitha pagesat e parashikuara në njohjen e borxhit do të bëhen, Artigiancassa do t'i kthejë njohjen e borxhit Huamarrësit të nënshkruar siç duhet dhe të vërtetuar.

Neni 11

Angazhimi i Huamarrësit

11.1 Angazhimi i Huamarrësit për të paguar shumat e detyrueshme sipas kësaj Marrëveshjeje dhe njohjen e borxhit në lidhje me të, është i pavarur, i pakushtëzuar dhe i parevokueshëm.

Neni 12

Pengesat dhe forcat madhore

12.1 Në rast të pengesave për zbatimin e programit për shkak të forcave madhore (si luftë përmbajtje, zjarr, tërmet, konflikte pune dhe greve, veprime të ndonjë qeverie, vështirësi të papritura të transportit, punës apo rasteve të tjera) do të aplikohen kushtet e specifikuar nga Marrëveshja Qeveritare. Artigiancassa do të ndjekë udhëzimet e Autoritetit Kompetent Italian lidhur me aktivitetet e programit.

Neni 13

Pezullimi i disbursimeve

13.1 Gjatë periudhës së disbursimit të Huasë së Butë, Artigiancassa rezervon të drejtën për të pezulluar ndonjë Kërkesë Disbursimi sipas nenit 8, në rast të ndonjë mospërmbushje përkundrajt Artigiancassa-s sipas kësaj Marrëveshjeje ose kredive të tjera financiare të dhëna nga Republika e Italisë Qeverisë ose Bankës Qendrore ose Agjencive Shtetërore të Republikës së Shqipërisë, sipas nenit 6 të ligjit nr.38 të 9 shkurtit 1979 dhe të nenit 6 të ligjit nr.49 të 26 shkurtit 1987 të Republikës së Italisë, si dhe të amendimeve të tij kohë pas kohe. Artigiancassa do të informojë në kohë Huamarrësin dhe bankën shqiptare për pezullim të tillë.

13.2 Artigiancassa do të ekzekutojë çdo Kërkesë Disbursimi parashikuar sipas nenit 8, në rast

se shumat korresponduese janë bërë disponibël nga Autoriteti Kompetent Italian. Artigiancassa nuk do të gjykohej përgjegjëse përballë Huamarrësit në rast se shuma për t'u disbursuar sipas Huasë së Butë nuk do të bëhet disponibël nga Autoriteti Kompetent Italian.

Neni 14 **Interesvonesa**

14.1 Nëse për ndonjë arsye, çfarëdoqoftë, Artigiancassa nuk merr shumat detyrim për principalin dhe/ose interesin në datën kur ato janë detyrim për t'u paguar, Huamarrësi do të jetë i detyruar t'i paguajë Artigiancassa mbi shumën e përmendur, interesvonesa që nga data e detyrimit deri në datën e kreditimit efektiv në favor të Artigiancassa ose të personit/ave të caktuar për këtë.

14.2 Ky interesvonesë, që rrjedh nga dështimi për të vepruar, do të përlllogaritet duke zbatuar formulën e interesit të thjeshtë me një normë prej 0.1% (zero presje një për qind) për periudhën prej 35 (tridhjetë e pesë) ditëve kalendarike, menjëherë vijuese nga data origjinale e detyrimit, dhe më pas me një normë prej 2.6% (dy presje gjashtë për qind) deri në datën e kreditimit efektiv të Artigiancassa. Ky i dyti, do të përditësohet nga Autoritetet Kompetente Italiane; një përditësim i tillë do të ndodhë nga 1 janari 2007.

14.3 Rishikimi ka si qëllim sjelljen e interesvonesës në të njëjtën linjë me, dhe për asnjë arsye jo më të lartë se Norma Referencë e Interesit Tregtar (NRIT) e publikuar çdo muaj nga OECD.

Neni 15 **Taksat**

15.1 Çdo taksë prezente ose e ardhshme të cilat mund të jenë të detyruara në Shqipëri për çfarëdo arsyeje të lidhur me këtë Marrëveshje dhe me deklaratën njohjen e borxhit, do të jenë në ngarkim të Huamarrësit.

15.2 Ndonjë taksë detyruese në Itali lidhur me këtë Marrëveshje nuk do të jetë në ngarkim të Huamarrësit.

15.3 Artigiancassa deklaron që do t'i nënshtrohet statusit të taksave, parashikuar sipas nenit 19 të dekretit të Presidentit të Republikës nr.601 të 29 shtatorit 1973, të amenduar herë pas here.

Neni 16 **Ligji qeverisës**

16.1 Kjo Marrëveshje do të qeveriset dhe rregullohet në përputhje me ligjin italian.

Neni 17 **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

17.1 Palët veç kësaj do të përpiqen të zgjidhin miqësisht ndonjë mosmarrëveshje të lindur ose nga interpretimi dhe/ose performanca e kësaj Marrëveshjeje.

17.2 Nëse këto përpjekje nuk çojnë në ndonjë zgjidhje të mosmarrëveshjes brenda një periudhe kohore të arsyeshme, mosmarrëveshja do të zgjidhet në një nivel qeveritar.

17.3 Nëse edhe kjo përpjekje do të dështonte ose (nëse përpjekja është bërë) nuk do të jepte një rezultat të kënaqshëm, të gjitha mosmarrëveshjet e ngritura prej ose në lidhje me marrëveshjen do të zgjidhen përfundimisht sipas rregullave të arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Paris, Francë nga një gjyq arbitrazhi prej tre arbitrash:

- një arbitër i emëruar nga Huamarrësi;
- një arbitër i emëruar nga Artigiancassa;
- arbitri i tretë do të emërohet nga arbitrat e lartpërmendur ose në rast të mosmarrëveshjes në mes tyre nga kryetari i Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë në Paris.

17.4 Nëse Huamarrësi ose Artigiancassa nuk emërojnë arbitrat e tyre brenda 30 (tridhjetë) ditësh prej kërkesës së palës tjetër, ky arbitër do të emërohet nga kryetari i Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë në Paris.

17.5 Vendimi i gjyqit të arbitrazhit, i cili do të vendosë në përputhje me ligjin e Republikës

Italiane, do të jetë përfundimtar dhe i detyrueshëm pa kushte për të dyja palët pa ndonjë mundësi apelimi.

17.6 Asnjë mosmarrëveshje ose debat që mund të ngrihet ndërmjet palëve për më tepër nuk do të pezullojë detyrimet e Huamarrësit për të paguar, në datën e përcaktuar të rënë dakord, të gjitha shumatat e përcaktuara sipas kësaj Marrëveshjeje dhe në veçanti të gjitha shumatat që rezultojnë prej pasqyrës së shlyerjeve të shprehura në nenin 8 më sipër dhe prej njohjes së borxhit që lidhet me të.

Neni 18

Njoftime

18.1 Njoftimet për t'u dhënë sipas kësaj Marrëveshjeje do të adresohen si më poshtë:

- Ministria e Financave: Bulevardi Dëshmorët e Kombit, Tirana-Albania, Tel +355 (4) 250264; - Fax 355 (4)228494;

- Raiffeisen Bank, in Albania: Rruga e Kavajës, Tirana, Tel +355 (4)22609, Fax +355(4)229304

- Artigiancassa S.P.A Via Crescenzo del Monte"-Romë-Italy Nucleo Operativo Lex N:49/1987, N: telephone 0039-06-5845529-561-414 Telefax N:0039-06-5845466.

Neni 19

Tekstet origjinale të Marrëveshjes financiare

19.1 Kjo Marrëveshje nënshkruhet në tre kopje në anglisht

V E N D I M

Nr.24, datë 3.4.2006

PËR CAKTIMIN E ANËTARËVE ZËVENDESIUES NË KOMISIONET E PËRHERSHME TË KUVENDIT

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të nenit 21 pika 3 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetares së Kuvendit, pas këshillimit me Kryetarin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

I. Caktimin e zëvendësuesve të anëtarëve të komisioneve të përhershme të Kuvendit, si më poshtë:

a) Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Ilir Bano PD

Luan Skuqi PD

b) Komisioni për Integrimin Europian

Gëzim Karapici PD

Aleksandër Biberaj PD

c) Komisioni për Politikën e Jashtme

Gazmend Oketa PD

Shkëlqim Ziri PD

ç) Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Sami Gjergji PD

Ardian Kollozi PD

d) Komisioni për Sigurinë Kombëtare

Pal Dajçi PD

Astrit Bushati PD

dh) Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Genc Juka PD

Gjokë Vuksani PD

e) Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë

Engjëll Cara PD

Baki Shehi PD

ë) Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

Astrit Patozi PD

Gilman Bakalli PD

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R E
Jozefina Topalli (Çoba)

V E N D I M
Nr.26, datë 20.4.2006

PËR CAKTIMIN E ANËTARËVE ZËVENDESES NË KOMISIONET
E PËRHERSHME TË KUVENDIT

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të nenit 21 pika 3 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetares së Kuvendit, pas këshillimit me Kryetarin e Grupit Parlamentar të Partisë Republikane,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

I. Caktimin e zëvendësuesve të anëtarëve të komisioneve të përhershme të Kuvendit si më poshtë:

a) Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Hajrulla Paturi PR

b) Komisioni për Integrimin European

Albert Faruku PR

c) Komisioni për Politikën e Jashtme

Besnik Bisha PR

ç) Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Genc Sharku PR

d) Komisioni për Sigurinë Kombëtare

Alfred Gega

PR

dh) Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Galip Ramadhi

PR

e) Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë

Lajla Përnaska

PR

ë) Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

Artur Hasanbelliu

PR

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R E

Jozefina Topalli (Çoba)

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 042 555 63; ose 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2006 është 18 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
- 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
- 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
- 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI**

1. PËR PROKURIMIN PUBLIK	1500
(2006).....	
2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005)	600
.....	
3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të-2006)	1500
4. PËR TAKSAT DHE TATIMET...(+ suplement 2006).....	1500
1. TREGUESI KRONOLOGJIK I	1500
LEGJISLACIONIT.....	
2. TREGUESI TEMATIK I	2000
LEGJISLACIONIT.....	

Botime të reja

1. PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500
2. KODI	1000
DOGANOR.....	
3. KODI DETAR	1000
.....	

Hyri në shtyp më 28.4.2006
Doli nga shtypi më 3.5.2006

Tirazhi: 4000 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2006

Çmimi 150 lekë